

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 2 / verë 2014



Editorial	2
<i>Gëzim Spahija</i>	
Çelësi për Shumëfishim: Formimi i Një Lëvizjeje Dinamike Kishëmbjellëse	3
<i>Kurt D. Plagenhoef</i>	
Një Kishë e Re, Një Lindje e Re: Dëshmia e Kishës në Shkallnur	9
<i>Gëzim Spahija</i>	
Kisha e Vogël Fokusuar së Jashtmi	10
<i>Eric Swanson</i>	
Mendësia 'Po'	14
<i>Michael Clarensau</i>	
Pastorimi Emocionalisht i Shëndetshëm	20
<i>Pete Scazzero</i>	
Brinja e Adamit	25
<i>Marcia Lednicky</i>	
Të Jetuarit Sipas Mbretërisë: Pjesa II	29
<i>Dr. H. Maurice Lednicky</i>	
Falenderim në Gilgal	35
<i>Terry L. Terrell</i>	

Tema e këtij numri: Kishë e vogël, ndikim i madh



Kishë e vogël, ndikim i madh...

“Kur ai mbërriti në vitin 1848,
aty nuk kishte të krishterë.
Kur ai u largua në vitin 1872, aty
nuk kishte më paganë.”

(Dr. Gjon Geddie)

Një dëshmi e tillë të inkurajon dhe të sfidon për të provuar
dhe për të marrë nga Zoti bekime edhe më të mëdha.

Zoti Jezus na ka garantuar që: “Ku janë dy apo tre të mbledhur në emrin tim, unë do të jem midis tyre”. Për këtë, nuk mund të bëhet krahasimi si një Kishë e vogël apo një Kishë e madhe, por krahasimi mund të jetë: një dëshmi e vogël apo një dëshmi e madhe. Ne jemi thirrur për të shpallur Lajmin e mirë të shpëtimit që vjen përmes sakrificës, vdekjes dhe ringjalljes së Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht, si dhe të tregojmë çdo ditë mrekullitë që Ai ka bërë dhe bën dita-ditës në jetën tonë. Sa më të gjallë të jemi në Zotin, aq më e fortë do të jetë dëshmia jonë në komunitetin ku jetojmë. Ishin vetëm 12 dishepujt që me vajosjen e Zotit dhe nën drejtimin e Frymës së Shenjtë ungjillizuan botën. Shërbesa jonë sot është të ecim në gjurmët e tyre, duke kërkuar drejtimin e Zotit për brezin tonë, për të cilin jemi përgjegjës. Jemi përgjegjës për mënyrën se si po e influencojmë dhe drejtojmë atë.

Është e vërtetë që ndoshta jemi një grup i vogël, por jemi me një dëshmi të madhe, sepse kemi dëshminë e një Zoti të gjallë, besnik dhe që na jep siguri, jo vetëm për të sotmen, por edhe për të ardhmen. Përmes njohurisë nga zbulesa e Perëndisë, ne i kemi mundësitë dhe përgjigjet për të gjitha problematikat që kjo botë po kalon. Bota ka nevojë të dëgjojë zërin e Kishës, mesazhin e Jezu Krishtit. Ne si besimtarë nuk jemi vetëm për t'i dhënë jetë një ndërtese, por që të sjellim jetën jashtë, aty ku ajo po mbaron çdo ditë. Na duhet kurajo dhe guxim,

thjeshtësi dhe përkushtim, forcë dhe drejtim që të jemi një ndihmë dhe përgjigje për situatat konkrete për njerëzit e kësaj bote. Jezusi është përgjigja për shpëtimin e tyre, çlirimi nga të gjitha paudhësitë dhe ligësitë me të cilat djalli mundohet që t'i mbajë të lidhur. Jezusi fitoi në kryqin e Kalvarit dhe na dha sigurinë e jetës së përjetshme me Të. Jezusi është rruga, e vërteta dhe jeta. Jezusi është fillimi dhe mbarimi i çdo gjëje. Ne jemi ndjekësit e Tij, prandaj duhet të kemi edhe namin e Tij. Thirrëmi të krishterë, ndjekës të një Zoti të vërtetë dhe të përjetshëm. Nuk ka rëndësi sa është numri juaj në kishë. Sot është dita që kisha e Zotit të ngrihet e të shpallë me forcë se Jezu Krishti është Zot. Në Të dhe nëpërmjet Tij, ne mund të kemi jetën.

Është koha që ne, kisha Shqiptare të fillojmë të korrim frytet e shërbesës sonë në ungjillizim dhe kishëmbjellje. Inkurajimi sot po na vjen nga Zoti, për një kishë në rritje, ku dishepujt të bëjnë dishepuj... dhe dishepujt të bëjnë dishepuj... dhe dishepujt të bëjnë dishepuj.



GËZIM SPAHIJA.

Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i
Përgjithshëm i Asambleve të
Perëndisë në Shqipëri

THESARE

Numri 2
Verë 2014

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Lindita Sqapi
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Tel: (+355) 48-302611
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Celësi për Shumëfishim:

Formimi i
një Lëvizjeje
Dinamike

KISHËMBJELLJEJE

Nga: KURT D. PLAGENHOEF

PJESA III

PARIMET E KISHËMBJELLJES

N

ë pjesën e parë të kësaj serie, sugjeruam që strategjia e Dhjatës së Re për përhapjen e ungjillit dhe zhvillimin e Mbretërisë së Perëndisë mbi Tokë është me anë të mbjelljes së kishave të reja. Ne diskutuam nevojën e zhvillimit të një lëvizjeje kishëmbjellëse me bazë biblike dhe të shëndetshme nga pikëpamja misiologjike për Asamblëtë e Perëndisë në Shqipëri. Në pjesën e dytë, eksploruam një misiologji të kishëmbjelljes në Veprat e Apostujve. Te pjesa e tretë do të shqyrtojmë parime, strategji dhe praktika të provuara të kishëmbjelljes.



“Unë do ta ndërtoj kishën time”

Mateu 16:18

Duke shkruar rreth kishëmbjelljes, misionari i Asambleve të Perëndisë, John York ka thënë: “Misionarët nuk duhet të humbasin asnjëherë nga sytë pohimin e Krishtit: ‘Unë do ta ndërtoj kishën time’ (Mat. 16:18). Pozicioni në të cilin qëndroj unë është se ky është një pohim qendror për sa i përket strategjisë së misionit. Ndërtimi i Kishës është objektivi imediat i misionit.”¹ Jam dakord që ndërtimi i kishës është themelor për misionin dhe kishëmbjellja është mënyra parësore, biblike, për ta përmbushur atë synim. Ka shumë shërbesa të ndryshme në të cilat mund të përfshihemi, por pyetja kyçe që duhet të bëhet është: “Si e ndërton kjo shërbesë kishën?”

Mbjellja e kishave individuale është një detyrë, por zhvillimi i një lëvizjeje kishëmbjelljeje që do të vazhdojë të shumëfishojë vetveten është tjetër gjë. Ky është synimi ynë brenda bashkësisë së Asambleve të Perëndisë në Shqipëri. Ralph Winter, një autoritet në përfundimin e detyrës së Porosisë së Madhe për të arritur të gjitha kombet, e ka shprehur në këtë mënyrë:

Detyra thelbësore misionare është që të themelohet një lëvizje e zbatueshme kishëmbjellëse që mbart potencialin për përtëritjen e familjeve të tëra të zgjeruara dhe transformimin e shoqërive të tëra. Kjo është e zbatueshme në kuptimin që ajo mund të rritet vetë, vendase në kuptimin që nuk shihet si e huaj, dhe një lëvizje kishëmbjellëse që vijon të riprodhojë bashkësi ndërbreznore që janë të afta që të ungjillizojnë pjesën tjetër të atij grupi popullate. Shumë vetë i referohen kësaj arritjeje të një lëvizjeje kishëmbjellëse vendase si një depërtim misiologjik.²

Mes viteve 1991 dhe 2013, misionarë të Asambleve të Perëndisë së bashku me bashkëpunëtorë vendas kanë themeluar nëntë kisha sovraane në Shqipëri. Këto kisha kanë nisur disa kishëmbjellje të tjera. Asambleja e Perëndisë në Durrës ka kryesuar në këtë rrugë duke qenë një shembull i fortë i shumëfishimit, duke filluar kishëmbjellje në katër

zona të tjera. Pas mbjelljes së gjeneratës së parë të kishave në vitet '90, theksi ynë është zhvendosur drejt trajnimit të shërbyesve, kishëmbjellësve dhe misionarëve me anë të Kolegjit Teologjik Ungjillor që u hap në vitin 2003. Kjo na ka pozicionuar për një rritje më të madhe në kishëmbjellje. Në 23 shkurt 2014, pata privilegjin që të predikoj në Asamblenë e Perëndisë në Shkallnur, ndërsa ata kremtuan kalimin nga një kishëmbjellje, në një kishë lokale të themeluar tashmë, dhe sovraane. Si kisha e parë e lëvizjes sonë e themeluar nga vendas dhe që e ndërmerr me sukses këtë hap, kjo ishte një ditë historike. Ky ishte vetëm fillimi i një kapitulli të ri në historinë e mbretërisë që është duke u shkruar nga kishëmbjellës shqiptarë që janë thirrur nga Perëndia dhe vajosur nga Fryma. Vitet 1990 ishin një dhjetëvjeçar i kishëmbjelljes së udhëhequr nga misionarët. Vitet 2000 ishin dhjetëvjeçari i trainimit të udhëheqësisë vendase. Vitet 2010 janë dhjetëvjeçari i kishëmbjelljes së udhëhequr nga drejtues vendas.

Aubrey Malphurs, autor dhe kishëmbjellës, parashtrohet gjashtë parime që janë kyçe për kishëmbjelljen dhe që do të doja të shqyrtoja dhe t'i ndaja me ju. Unë besoj se këto parime përputhen me kishëmbjelljen që ne po kërkojmë të themelojmë në Shqipëri. Ka shumë praktika e metoda të ndryshme të kishëmbjelljes që mund të përdoren efektivisht, dhe këto do të ndryshojnë me kohën dhe kontekstin, por parimet biblike nuk do të ndryshojnë kurrë.

NJË VIZION SIPAS POROSISË SË MADHE: NDËRTIMI I ZJARRIT NË FURRË

Malphurs thekson se: “Që kisha e re të ketë një sukses të plotë, është kritike që ajo të ketë një vizion të vetëm e të qartë.”³ Ndërkohë që i bëjmë vetes pyetjen se çfarë duhet të jemi duke bërë dhe kë duhet të jemi duke arritur, “Përgjigjet e këtyre pyetjeve pa dyshim janë Porosia e Madhe dhe njerëzit e humbur.”⁴ Porosia e Madhe e Krishtit, urdhërimi i tij i fundit pas ringjalljes për të “shkuar në të gjithë botën dhe predikuar ungjillin” dhe për të “bërë dishepuj nga të gjitha kombet”, përsëritet me

fjalë të ndryshme në fund të çdo ungjilli (Mateu 28:18-20; Marku 16:15-18; Luka 24:46-48; Gjoni 20:21-23). Këto janë shumë qartë urdhrat e mësymjes për kishën dhe vizioni misionar i kishëmbjelljes.

“Që kisha e re të ketë një sukses të plotë, është kritike që ajo të ketë një vizion të vetëm dhe të qartë.”

Në mbjelljen e kishave të reja, ne jemi duke kërkuar që të arrijmë të humburit me mesazhin shpëtues të Jezus Krishtit. Pasioni që na nxit në shërbesë dhe barra në lutje duhet të jetë që Perëndia të na përdorë në shpengimin e njerëzve të humbur. Ne i kërkojmë ata, dhe Perëndia i shpëton. Ne e shohim këtë zjarr të digjet në kishën e shekullit të parë ndërsa ata ungjillizonin botën e tyre, dhe e shohim edhe sot në kishën e shekullit të njëzet e njëte, që është kërkimi për të ungjillizuar të gjithë ata që akoma duhet të dëgjojnë ungjillin për herë të parë.

Misiologët Winter dhe Koch rrokin zemrën e vizionit të kishëmbjelljes duke thënë: “Ajo çfarë duhet në çdo komb është që ungjilli të fillojë të depërtojë nëpër të gjithë grupin me aq fuqi detyruese e jetëdhënëse sa që kishat që do të rezultojnë të mund të përfundojnë vetë përhapjen e ungjillit në çdo person.”⁵ Unë besoj që kjo është një pjesë kyçe e mënyrës se si mund të përmbushet Porosia e Madhe. Kishat që ne mbjellim duhet të jenë në gjendje të mbjellin kisha të tjera për të arritur komunitetin e tyre dhe grupet e njerëzve të tyre. Një shembull i mirë i kësaj që e shohim është kisha në Institut që zgjeron ungjillizimin dhe fillon një kishëmbjellje në Bathore. Që nga fillimi i kësaj pune të re në Bathore në qershor të vitit 2013, rreth 15 veta kanë ardhur në Krishtin dhe mbi 150 persona janë pjesë e shërbesave javore. Lavdi Zotit! Deri në këtë moment, ne kemi nëntë kishëmbjellje të tilla në Shqipëri, që është mirë, por është vetëm fillimi i asaj që duhet të ndodhë. A është kisha jote duke e shumëfishuar vetveten?

Ndërsa njerëzit fitohen për Krishtin, atëherë ata duhet të mbledhen në bashkësi ku mund të rriten dhe

të shërbejnë. Në Shqipëri dhe Ballkan kemi shumë zona ku nuk ka asnjë kishë. Themelimi dhe shumëfishimi i bashkësive të besimit është i rëndësishëm. Unë besoj se në Asambletë e Perëndisë në Shqipëri ne kemi një vizion sipas Porosisë së Madhe për të humburit, por na duhet të zhvillojmë një kuptim më të thellë për atë se sa jetësore është kishëmbjellja për procesin e ungjillizimit dhe dishepullizimit të njerëzve. “Kishëmbjellja është ungjillizimi, dishepullizimi dhe aktiviteti i qëllimshëm që rezulton në themelimin e një kishe lokale. Ungjillizimi dhe dishepullizimi janë shërbesa jetësore të një kishe, por në izolim ato nuk janë mbjellje kishe.”⁶ Pra, nevojat për ungjillizim dhe dishepullizim biblik janë të qarta, por mbjellja e një kishe përfshin shumë më tepër se kaq.

NJË UDHËHEQËSI SHËRBYESE E FORTË: UDHËHEQJA ME PËRSOSMËRI

Unë bie dakord me pastorin dhe kishëmbjellësin Ralph Moore që: “Klerikët e trajnuar në vend përbëjnë pjesën e parë të një formule për shumëfishimin e shpejtë të kishës.”⁷ Përveç trajnimit të besimtarëve në nivelin e kishës lokale, ne jemi gjithashtu duke trajnuar shërbyes me anë të shkollës sonë biblike (KTU) në Tiranë. Kjo është pjesë jetësore e prodhimit të udhëheqësve për të shërbyer në kishat e reja. Unë besoj që ne jemi duke arritur një pikë të masës kritike në trajnimin e drejtuesve që do të çojë në dhjetëvjeçarin e ardhshëm në kishëmbjelljen më të përsheptuar që kemi parë ndonjëherë.

Malphurs përkufizon llojin e udhëheqësve-shërbëtorë që ne jemi duke u përpjekur të prodhojmë. “Drejtuesit e krishterë janë njerëz të perëndishëm (karakter) që e dinë se ku po shkojnë (vizioni) dhe kanë ndjekës (influenca).”⁸ Ne duhet të modelojmë dhe t’iu mësojmë një karakter të perëndishëm dishepujeve tanë. Ne duhet gjithashtu të udhëheqim me një vizion të qartë se ku jemi duke shkuar dhe çfarë duam të realizojmë. Ne duhet të pranojmë që përkushtimi nuk mund të arrihet me anë të një autoriteti komandues, por përmes një ndikimi me dashuri në kontekstin e marrëdhënieve të mirëbesimit. Çdo gjë qëndron apo rrëzohet bazuar në udhëheqësinë dhe ne jemi të përkushtuar për të qenë drejtues të perëndishëm dhe për të trajnuar drejtues të tillë, vizionarë dhe ndikues, me karakterin, përkushtimin dhe aftësinë për ta bërë punën.

Udhëheqësit-shërbëtorë duhet gjithashtu të marrin pozicionin e një nxënësi në mënyrë që të mishërojnë ungjillin për ata që po ungjillizojnë. “Fakti i parë domethënës në lidhje me mishërimin është që Jezusi erdhi si një foshnjë e brishtë (dhe) që Jezusi ishte një çirak (nxënës).”⁹ Ndërsa ne udhëheqim dhe kërkojmë të prodhojmë udhëheqës, një qëndrim përulësie do t’i ndihmojë të tjerët që të shohin dhe të ndjekin Krishtin brenda nesh. Ne mësojmë dhe përpiqemi që të modelojmë udhëheqje shërbyese në KTU. Modeli diktatorial, kontrollues i udhëheqjes që është parë në të kaluarën në Shqipëri është stili i vetëm udhëheqës që kanë njohur shumë vetë. Modeli i Jezusit si udhëheqës-shërbëtor është revolucionar dhe jetëndryshues.

NJË USHTRI E MIRË-MOBILIZUAR

BESIMTARËSH: ÇDO ANËTAR, NJË SHËRBYES

Tek 1 Korintave 12, Pali e krahason kishën me një trup të përbërë nga shumë gjymtyrë. Secila pjesë ka vlerën, dhuntitë dhe funksionin e vet të veçantë në plotësimin e trupit. Kjo është një tablo shumë e vërtetë e trupit të Krishtit. Çdo anëtar është i nevojshëm për të përbërë një trup të shëndetshëm, qofshin ata organe të brendshme, apo tipare të jashtme. Peter Drucker shkruan: “Njerëzit përcaktojnë kapacitetin performues të një organizate. Asnjë organizatë nuk mund ta tejkalojë cilësinë e njerëzve që ka.”¹⁰ Çdo kishë duhet të arrijë ta angazhojë çdo anëtar në shërbesë, dhe kishëmbjelljet që nuk i kanë mundësitë siç mund t’i ketë një kishë tashmë e stabilizuar, kanë nevoja edhe më të mëdha.

Pastori ka përgjegjësinë për të ndihmuar çdo anëtar të një kishëmbjelljeje që të kuptojë rëndësinë e tij apo të saj në mbjelljen e kishës dhe në planin e përgjithshëm të Perëndisë. Skuadra që Perëndia ka thirrur së bashku në kishëmbjelljen e Asamblesë së Perëndisë në Bathore e përbërë nga dy shqiptarë (të dy të diplomuar në KTU), dy brazilianë, një rumune dhe një finlandeze, është mahnitëse, dhe më tregon që Perëndia ka një plan të mrekullueshëm për atë zonë. Skuadra jonë shumëkombëshe kishëmbjellëse e përbërë nga dy misionarë shqiptarë dhe tre misionarë rumunë në Shkup, Maqedoni, është një partneritet i fuqishëm dhe një kombinim unik dhuntish për shërbesë. Unë besoj se këto lloj partneritetesh shumëkombëshe janë një çelës strategjik për përpjekjet tona të kishëmbjelljes dhe misionit. Në

mënyrë që secili anëtar i skuadrës të kuptojë dhe vlerësojë rolin e vet të veçantë, është kritike që ai apo ajo të kuptojë si thirrjen e vet për shërbesë, ashtu edhe dhuntitë me të cilat Perëndia i ka pajisur. Studimi i mëposhtëm pasqyron rëndësinë e dhuntive frymërore si një nga faktorët kryesorë që nevojiten në kishat.

Christian Schwarz ka publikuar rezultatet e një studimi kërkimor në tridhjetë e dy vende dhe njëmijë kisha. Ai i identifikon tetë cilësitë thelbësore të kishave të shëndetshme si 1) udhëheqje e fuqizuar, 2) shërbesë sipas dhuntive, 3) përshtetshmëri me pasion, 4) struktura funksionale, 5) shërbesa adhurimi frymëzuese, 6) grupe të vogla gjithëpërfshirëse, 7) ungjillizim sipas nevojave, dhe 8) marrëdhënie të ngrohta.¹¹

Si drejtues, ne duhet të dallojmë dhuntitë e njerëzve dhe t’i inkurajojmë dhe ndihmojmë ata që të funksionojnë në fushën e dhuntive të tyre. Kjo mund të përbëjë ndryshimin mes suksesit dhe dështimit në shërbesë për shumë njerëz.

Siç mund të kuptojmë nga 1 Korintasve 12, “parimi është që të vendosësh njerëzit e duhur në vendet e duhura për arsyet e duhura që çdo anëtar të bëhet një shërbyes.”¹² Kjo do të na mbushë me gëzim dhe kënaqësi ndërsa ne merremi me punën e vështirë të mbjelljes së kishave në territore ku nuk është punuar më parë.

NJË SHËRBESE E PËRPUTHUR ME KULTURËN: DERDHJA E VERËS SË RE NË KACEKË TË RINJ

Duke vënë në dukje ndryshimet mahnitëse që kanë ndodhur në shekullin e njëzetë, Malphurs me të drejtë shkruan: “Ndërsa bota jonë ndryshon, kisha ungjillore duhet të ndryshojë ndërkohë që përpiqet që të komunikojë mesazhin e Jezus Krishtit... kishat tona të mbjella duhet të jenë të përshtatura me kulturën nëse duhet të arrijnë për Shpëtimtarin këtë brez dhe brezat e ardhshëm të pakishëzuar.”¹³ Unë besoj se kjo është pikërisht çfarë do të thotë të jesh

një kishë misionare. Ne duhet ta kontekstualizojmë mesazhin tonë dhe përjasjen ndaj kulturës në të cilën jemi duke shërbyer në mënyrë që ungjilli të ketë kuptim. Në një kontekst të huaj ku kultura dhe gjuha janë kaq të ndryshme, ne jemi më të vetëdijshëm për nevojën për të komunikuar mes kulturash, por unë jam i bindur se ne duhet ta trajtojmë në të njëjtën mënyrë edhe kur jemi duke mbjellë një kishë në kontekstin e kulturës sonë në Shqipëri.

Ne duhet të prezantojmë një mesazh dhe një mënyrë të jetuari të cilat të jenë në përputhje me kulturën dhe të jenë të sprovuara me vërtetësi. Ed Stetzer thotë: “Vërtetësia është thelbësore, dhe vërtetësia vjen vetëm kur ne jemi realë dhe të pranishëm. Kjo ‘prani’ është ajo që teologët e quajnë mishërim.”¹⁴ Ndërsa i futemi kësaj sipërmarrjeje për themelimin e një lëvizjeje kishëmbjellëse, synimi ynë është që të jemi kishëmbjellës autentikë, me ndikim të rëndësishëm, kishëmbjellës të mishëruar dhe kontekstualë. Kisha Lajmi i Mirë në Fier është një shembull i mirë i kësaj ndërsa janë duke ungjillizuar komunitetin rom me duart e Krishtit, duke i sjellë ndihmë fizike dhe shpresë frymërore atij komuniteti.

Ne jemi duke synuar që ta bëjmë të tërë shërbesën tonë kontekstuale. “Ideja e kontekstualizimit është që ta hartojmë mesazhin e ungjillit në gjuhën dhe format e duhura të komunikimit, të cilat janë të kuptueshme për kulturën lokale dhe ta fokusojmë mesazhin mbi çështjet kyçe në jetët e njerëzve.”¹⁵ Ne duhet të kërkojmë që të përdorim format kontekstuale të të dëshmuarit, adhurimit, mësimi dhe literaturës në aktivitetet tona kishëmbjellëse. Fakti që më shumë këngë dhe libra janë duke u shkruar nga besimtarë shqiptarë është një hap i mirë drejt këtij synimi. Këngë të tilla si “Qielli dhe Toka Lavdërojnë Zotin,” që është bërë nga besimtarë të Asamblesë së Perëndisë në Institut, shprehin zemrën dhe ritmet e Shqipërisë. Ungjilli për shqiptarët duhet të “këndohet shqip” në mënyrë që të mbillen kisha shqiptare që u flasin zemrave të njerëzve dhe që shumëfishojnë vetveten.

NJË ADHURIM I VËRTETË GJITHËPËRFSHIRËS: ADHURIM QË BËN NJË NDRYSHIM

Çfarë është adhurimi i vërtetë gjithëpërfshirës? Malphurs e përkufizon atë si “një reagim aktiv ndaj Perëndisë në të cilin ne pranojmë vlerën e Tij të madhe.”¹⁶ Adhurimi i vërtetë do të sjellë një ndikim të madh në kishëmbjelljen tonë. Ai fillon me një jetë

personale adhurimi që derdhet pastaj në skuadrën dhe në aktivitetet tona kishëmbjellëse. Nëse ne na shohin si të singertë dhe realë në marrëdhënien tonë me Zotin, atëherë kjo do të bëjë një ndryshim të pamasë në jetët e atyre që ndjekin shembullin tonë. Kohët e fundit kam marrë pjesë në një shërbesë adhurimi në Asamblenë e Perëndisë në Durrës, dhe zemrat dhe lotët e besimtarëve gjatë adhurimit më kanë prekur me singëritetin e dashurisë së tyre për Perëndinë. Ata më frymëzuan që të dua të adhuroj bashkë me ta, këtë Perëndi që është kaq i denjë për lëvdimin tonë.

Malphurs shpjegon rëndësinë e adhurimit. Për shkak se adhurimi theksohet shumë në Bibël, ai i ndërton njerëzit dhe është përbërës i pandashëm i bashkësisë. Ai detajon elementet e adhurimit si admirim, rrëfim, falënderim, përkushtim, përgjërëm dhe shpallje. Rezultatet e adhurimit të vërtetë janë një përkushtim më i madh i jetëve tona ndaj Krishtit dhe një përvojë gjithëpërfshirëse që prek gjithë qenien tonë. Adhurimi kërkon që ne vetë si drejtues të jemi adhures, që adhurimi ynë të jetë i përputhur me kulturën, që të bëhet mirë, që të ketë mjedisin e duhur dhe që të jetë krijues dhe me risi.¹⁷ Fryma e Shenjtë do të na ndihmojë që t'i japim lavdinë Perëndisë ashtu siç Ai meriton.

Jezusi tha që: “Perëndia është Frymë dhe ata që e adhurojnë, duhet ta adhurojnë në Frymë dhe në të vërtetën” (Gjoni 4:24). Ndërsa ne adhurojmë Perëndinë në këtë mënyrë, të tjerët do të tërhiqen ndaj besimit dhe mesazhit tonë. Në bashkësinë e Asambleve të Perëndisë, adhurimi është një pikë e fortë e komunitetit tonë të krishterë dhe dëshmimit tonë ungjillizues. Shumica e këngëve tona të adhurimit janë të përkthyer nga perëndimi, por siç thashë më parë, gjithmonë e më shumë muzikantë shqiptarë janë duke shkruar këngë të tyre në stilin shqiptar që do të prekë zemrat e njerëzve akoma më mirë. Ne kemi shumë njerëz që kanë dhunti në muzikë dhe arte, dhe ne duhet t'i përdorim këto dhunti në aktivitetet tona kishëmbjellëse. Si pjesë e një partneriteti me Karvanin e Shpresës në Europë (Convoy of Hope Europe) dhe Projekti Adopto një Komunitet në Fushë Krujë, kisha Asambleja e Perëndisë atje ka trajnuar disa të rinj që të luajnë në kitarë, dhe tani dy prej atyre adoleshentëve janë duke drejtuar adhurimin. Ata janë duke bërë një ndryshim në komunitetin e tyre nëpërmjet adhurimit.



NJË UNGJILLIZIM BIBLIK DHE NË PËRPTHJE ME KULTURËN: NDJEKJA E NJERËZVE TË HUMBUR ME PASION

Në mënyrë që ungjillizimi ynë të jetë efektiv, ai duhet të jetë në përputhje me kulturën. Kjo është e vërtetë në Shqipëri dhe kudo në botë. Çdo kulturë ka botëkuptimin e vet, vlerat e veta dhe mënyrat e veta të komunikimit. Dëshmimi ynë ungjillizues, ashtu si dhe kisha që po përpqemi të themelojmë, duhet të ketë një natyrë vendase në mënyrë që të lidhet siç duhet me njerëzit. "Fjala 'vendase' do të thotë diçka autoktone, e brendshme, kombëtare. Është ajo që buron dhe zhvillohet nga brenda një kulture të caktuar... Mbjellja e kishave vendase është fara e Ungjillit në kontekstin vendas të mendimit apo gjërave, duke e lejuar Frymën e Shenjtë të bëjë punën e vet në kohën dhe mënyrën e vet."¹⁸ Ungjillizimi ynë duhet të ketë këtë lloj ndjesie dhe përqsje natyrale në mënyrë që të jetë i pranuar jo si diçka e huaj, por si diçka e kuptueshme dhe kuptimplote në këtë kulturë. Vitin e kaluar në Turqi ne bëmë "Natën e Shqipërisë" tek kisha në Stamboll ku dhe ndamë dëshmi personale dhe kënduam e kërcyem këngë e valle folklorike shqiptare. Të ftuarit turq e pëlqyen shumë dhe u bashkuan në valle. Kjo qe diçka që i shkoi për shtat kulturës së vendit.

Ne po përpqemi që të zhvillojmë një lëvizje kishëmbjelljeje, jo thjesht të kopjuar nga misionarët. Kultura në Shqipëri është shumë e bazuar në marrëdhëniet, dhe format e ungjillizimit që bazohen në marrëdhëniet si dalja për kafe apo vizitat në shtëpi janë më të natyrshmet dhe të pranueshmet. Kjo është një pjesë parësore e metodologjisë sonë. Një besimtar në Tiranë është duke ungjillizuar shumë burra duke luajtur bilardo dhe ping-pong me ta. Ne duhet të ungjillojmë edhe me një ndjeshmëri kulturore përveçse me një botëkuptim të krishterë. "Mbjellja e kishave vetë-qeverisëse, vetë-financuese, vetë-shprehëse, vetë-mësuese, dhe vetë-përhapëse, nuk është një fantazi e tepruar kur botëkuptimi i krishterë bëhet një realitet i gjallë në kishat që ai mbjell."¹⁹ Përqsja vendase dhe e bazuar në marrëdhëniet do t'i japë formë ungjillizimit tonë dhe strategjive të kishëmbjelljes në Shqipëri.

Ndërsa ne ia përkushtojmë veten parimeve të Porosisë së Madhe, për udhëheqës shërbëtorë, ku çdo besimtar është një shërbyes, për të pasur përputhje kulturore, adhurim të vërtetë, dhe

ungjillizim adekuat, Perëndia do të na përdorë për të mbjellë kisha të forta dhe të shëndetshme që do të rriten dhe do të shumëfishojnë vetveten. Le të përkushtohemi ndaj Krishtit dhe ndaj njëri-tjetrit për të qenë pjesë e lëvizjes më të madhe kishëmbjellëse që ka parë ndonjëherë Shqipëria dhe Ballkani. Me hirin e Perëndisë, fuqinë e ungjillit dhe vajosjen e Frymës së Shenjtë, ne mund dhe duhet ta bëjmë këtë për hir të të humburve për të cilët vdiq Krishti.

Shënimet:

- ¹ York, John. *Missions in the Age of the Spirit*. Springfield, MO: Logion Press, 2000: 240.
- ² Winter, Ralph D. and Bruce A. Koch. "Finishing the Task: The Unreached Peoples Challenge." *International Journal of Frontier Missions* 16:2 (Summer 1999): 71.
- ³ Malphurs, Aubrey. *Planting Growing Churches for the 21st Century: A Comprehensive Guide for New Churches and Those Desiring Renewal*. Grand Rapids: Baker Books, 1998: 119.
- ⁴ Ibid 1998:121.
- ⁵ Winter and Koch 1999: 71.
- ⁶ Wan, Enoch and John Mark (pseudonyms of Christian workers serving in Turkish context). "Ministering in Turkish Context: Proposing a Five-Stage Model for Church Planting." *Featured Article of www.GlobalMissiology.org* (January 2011): 1-27:12.
- ⁷ Moore, Ralph. *Starting a New Church: The Planter's Guide to Success*. Ventura, Calif.: Regal Books, 2002: 104.
- ⁸ Malphurs 1998: 106.
- ⁹ Lingenfelter, Sherwood G. and Marvin K. Mayers. *Ministering Cross-Culturally: An Incarnational Model for Personal Relationships*. Grand Rapids: Baker Books, 1986: 16.
- ¹⁰ Drucker, Peter. *Managing the Non-Profit Organization*. New York: Harber Business, 1990: 145.
- ¹¹ Schwarz, Christian A. *Natural Church Development: A Guide to Eight Essential Qualities of Healthy Churches*. Carol Stream, IL: ChurchSmart Resources, 1996: 61.
- ¹² Malphurs 1998: 151.
- ¹³ Malphurs 1998: 165.
- ¹⁴ Stetzer, Ed. *Planting New Churches in a Postmodern Age*. Nashville, Tenn.: Broadman & Holman Publishers, 2003: 140.
- ¹⁵ Lingenfelter 1986: 12.
- ¹⁶ Malphurs 1998: 189.
- ¹⁷ Ibid 1998: 188-193.
- ¹⁸ Brock, Charles. *Indigenous Church Planting: A Practical Journey*. Neosho, MO: Church Growth International, 1994: 99.
- ¹⁹ Ibid 1994: 27.



KURT D. PLAGENHOEF, M.A.

Zv.Drejtor Ekzekutiv KPAPSH dhe President i Kolegjit Teologjik Ungjillor, misionar në Shqipëri prej 19 vitesh.



Një Kishë e Re, Një Lindje e Re

Dëshmia e kishës në Shkallnur

Nga: GËZIM SPAHIA

Është koha që ne si Kisha Ungjillore të Asamblesë të ngrihemi dhe të marrim përgjegjësitë, për të dhënë shembullin tonë për të qenë kripë e dritë në këtë botë. Jezusi i përgatiti në mënyrë të shkëlqyer dishepujt e tij, për rolin të cilin duhet të luanin, jo vetëm për kohën në të cilën Ai do të ishte me ta, por edhe për të ardhmen. Ai i mësoi ata jo vetëm përmes parimeve të Shkrimeve, por edhe me shembullin e tij praktik. Shkolla e tij ishte të merrnin pjesë në të gjithë shërbesën e tij të ungjillizimit dhe të mrekullive. Jezusi na urdhëroi që ta ndajmë Ungjillin në qytetet dhe fshatrat përreth.

Kisha në Shkallnur ka lindur duke u bazuar në Fjalën e Zotit e cila thotë që në qoftë se gjeni një derë të hapur në një shtëpi, aty qëndroni. Sikurse Perëndia na bekoj me Lajmin e Mirë të shpëtimit të sjellë përmes misionarëve të tij, akoma më shumë sot ne këtë mesazh duhet ta përcjellim si një stafetë për ata të cilët akoma nuk e kanë marrë. Ky është edhe parimi i kishës vendase që ne kemi në vizionin e Asambleve të Perëndisë, për një kishë e cila duhet të bëhet vetëqeverisëse, vetëfinancuese, vetëshumëfishuese.

Kisha në Shkallnur lindi si një mision i kishës në Durrës. Ajo u nis nga besimtarët shqiptarë të kësaj kishe dhe u rrit e u bë e pjekur për të funksionuar në

vetvete në mënyrë të pavarur nga të huajt. E gjitha nisi nga dëshmia e një motre të vetme, e cila kishte marrë Ungjillin dhe gufonte në zemrën e saj me dëshirën për ta ndarë me të tjerët. Nën drejtimin e Frymës së Shenjtë, përmes një shpalljeje të pushtetshme, me thjeshtësinë dhe fuqinë e dëshmisë së mrekullisë së shpëtimit, Zoti filloi të shpëtojë ata të cilët e hapën zemrën për Perëndinë.

Është e vërtetë që një dritë mund ta ndriçojë gjithë shtëpinë, siç është shkruar: "Beso në Zotin Jezus dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote". Kështu, do të shpëtohesh ti dhe familja jote, por edhe ti dhe komuniteti yt në të cilin ti banon. Krishti na ka dhënë një vizion të gjerë të të korrave të tij; plani i tij për secilin nga ne është në funksion të kishës së tij. Po ashtu, Krishti punoi më parë për përgatitjen e drejtuesve për të korrat e tij. Nuk mund të quhej sukses shërbesa e tij pa gjenerimin që u krye më pas nga dishepujt e tij.

Kështu është edhe për ne, dishepujt e tij; ne duhet të bëjmë dishepuj dhe pastorët duhet të evidentojnë dhe të investojnë për përgatitjen e shërbestarëve. Duke parë në zgjedhje, duke parë thjeshtësinë e besimit dhe përulësinë në shërbimin e të bërit të gjërave, këto janë një pikënisje e mirë për të investuar, siç edhe ka ndodhur me pastorin e

tanishëm Kostandin Gode në Shkallnur, tek i cili është investuar përmes Kolegjit Teologjik Ungjillor për rritjen e tij teologjike, si dhe për përgatitjen e tij në shërbesë.

Për lavdinë e Zotit, sot kisha në Shkallnur është e ndarë dhe funksionon si një kishë më vete me 42 anëtarë, rreth 38 fëmijë dhe rreth 25 simpatizantë, me tetë shërbesa të ndryshme në javë. I jam mirënjohës Perëndisë që na ndihmon dhe kurorëzon përpjekjet tona, për të qenë të privilegjuar dhe për t'u përdorur si instrumente në shërbesën e tij.

Ky është edhe shembulli dhe drejtimi që duam të ndjekim në lëvizjen tonë për shumëfishimin e kishës kombëtare duke lëvizur dhe duke plotësuar qëllimin që të jemi një lëvizje kishëmbjelljesh.

Pastorë shqiptarë, merrni zemër dhe një vizion të ri sot, sepse ka ardhur koha që ne shqiptarët të mbjellim më shumë kisha, të bekuar dhe të ndihmuar nga misionarët të cilët do të jenë pranë nesh në rolin e tyre për mbështetje, inkurajim, lutje, si dhe për dhënien e këshillave, por na takon neve si kisha shqiptare të jemi gati që ta marrim përsipër dhe ta plotësojmë këtë thirrje të lartë.

Se si do të jetë kisha nesër, varet shumë nga mënyra si mbjellim sot. Le të mbjellim pra, me lot dhe me besim se në kohën e duhur Zoti do na shpërblejë me të korrat e tij me gëzim.

Kisha e vogël e fokusuar së jashtmi:

Si të kalosh nga Mirëmbajtja në Mision

Nga ERIC SWANSON

*Ju mund të mos bëheni
kurrë kisha më e mirë
NË komunitet,
por mund të bëheni
kisha më e mirë
PËR komunitetin.
Ja se si...*

K

**Kur dy pastorë takohen,
brenda dy minutave të para,**
është e sigurt që njëri do të pyesë:
“Cilën kishë drejtoni?”, ose “Sa
pjesëmarrje keni në takimet e të
dielave?” Njerëzit duan të shohin se
në ç’nivel janë ata, duke u
krahasuar me kolegët e tyre.

Por, po sikur biseda të ndryshonte? Po sikur në vend të
kësaj, të bëhej pyetja: “Më tregoni se si po ndikon kisha
juaj në komunitetin që ju rrethon?” Ne fillojmë të masim, jo
përmasat e kishës, por përmasat e gjurmëve të kishës në
komunitet. Dhe kisha më e vogël, pak nga pak, është e
aftë të ketë ndikimin më të madh.

NJË PIKAVARAZH NDRYSHE

Kishat e fokusuar nga jashtë kanë një tjetër lloj pikavarazhi. Përkufizimi që unë përdor për një kishë të fokusuar nga jashtë është një kishë që e mat efektivitetin e saj, jo me pjesëmarrjen në takimet e të dielave, por me ndikimin që ka mbi komunitetin që e rrethon. Të jesh një kishë e fokusuar së jashtmi nuk do të thotë përpjekje për t'u bërë kisha më e mirë në komunitet, por kisha më e mirë për komunitetin.



Si mund të ketë një kishë e vogël një ndikim të madh? Në këtë artikull, unë do të përvijoj avantazhet e të qenurit kishë e vogël, do ekspozoj disa konstrukte ndihmuese te-

ologjike, do paraqes disa mënyra si mund të fillohet dhe do t'ju tregoj për disa kisha të vogla që janë duke lënë gjurmë të mëdha.

AVANTAZHI I VOGËLSISË

Përdorni pikat tuaja të forta. Ju aktualisht ndodheni në gjendjen ku po përpiqen të arrijnë kishat e mëdha. Vogëlsia është risia e madhe e kohëve të fundit. Lexoni librat apo artikujt mbi mega-kishat dhe shikoni se çfarë po përpiqen të bëjnë ato. Ato po përpiqen të bëhen më të vogla. Me anë të grupeve të vogla, komplekseve me ambiente të shumta, përdorimit të mençur të hapësirave të përbashkëta dhe ndërtimit të bashkësive të vogla në rezidencat studentore, ato e kanë kuptuar me intuitë që njerëzit duan të jenë pjesë e një komuniteti ku të tjerët ua dinë emrin, dinë emrat e fëmijëve të tyre dhe që do iu ndjehet mungesa nëse nuk do të frekuentonin apo merrnin pjesë në to. Atyre iu pëlqen kur 58 për qind e anëtarëve të bashkësisë së tyre i frekuentojnë rregullisht çdo javë shërbesat, siç ndodh në kishat e vogla, krahasuar me 28 për qind që frekuentojnë çdo javë shërbesat në kishat me mbi 2,500 vetë. Ata do të pëlqenin të kishin adhurimin ndërbreznor që ju kenë. Ata e lakmojnë përqindjen e vullnetarëve dhe drejtuesve dalë nga besimtarët e thjeshtë dhe sa shumë që jeni në gjendje të bëni ju me një numër kaq të pakët. Njerëzit e ndjejnë që dikush që thirret pastor duhet në të vërtetë të jetë pastor dhe bari i njerëzve, dhe jo vetëm një kryetar i një organizate. Në shumë mënyra ata duan të jenë si ju.

TEOLOGJIA E FOKUSUAR SË JASHTMI


Lëvizjet e Perëndisë fillojnë kur njerëzit lexojnë Shkrimet me një vështrim të freskët. Kam parë disa konstrukte teologjike që kanë dalë në pah dhe kanë marrë krahë përreth shërbesës së fokusuar nga jashtë.

1. Shërbimi është pjesë e planit të madh të Perëndisë për çdo ndjekës të Jezus Krishtit.

Shumica prej nesh e citojnë Efesianëve 2:8,9 mbi mënyrën si ndodh shpëtimi: "Nga hiri... me anë të besimit ... dhuratë e Perëndisë ... jo prej veprave." Kur vijmë tek Krishti me anë të besimit, kjo e mbush atë boshllëk që ka formën e Perëndisë në jetët tona. Vargjet 8 dhe 9 tregojnë se si shpëtohem ne. Por Efesianëve 2:10 tregon arsyen: "Ne në fakt, jemi vepra e Perëndisë, krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira, që Perëndia i përgatiti që më parë, që ne të ecim në to." Fakti që Ai përgatiti që më parë veprat që ne bëjmë, sinjalizon praninë e një boshllëku të dytë në jetët e besimtarëve — një boshllëk që ka të bëjë me qëllimin. Pra, një pjesë kritike e të qenurit dishepull është që të kuptosh me anë të eksperimentimit, gjërat e përbashkëta mes pasionit tonë dhe qëllimit të Perëndisë, ku ne ndjejmë që janë të pëlqyeshme për Perëndinë apo ku ne ndjehemi plotësisht të gjallë.

2. Ne mësojmë me anë të predikimit, devocioneve, dhe studimit të Biblës, por nuk rritemi në të vërtetë (përtej një pike të caktuar) derisa fillojmë t'iu shërbejmë të tjerëve.

Në vitet e kaluara, Diana Garland dhe kolegët e saj në Universitetin Baylor kanë bërë një punë kërkimore për të parë se sa lidhet besimi me shërbimin. Ata anketuan 7,300 persona në 35 bashkësi dhe kanë zbuluar se ata që janë të përfshirë në shërbim në komunitetin e tyre "raportuan se luteshin, vinin në shërbesat e adhurimit, dhe jepnin financiarisht, në gjithçka më shumë se ata që nuk ishin të përfshirë në shërbim... Fëmijët dhe adoleshentët — ashtu si dhe të rriturit — rriten në besim duke u përfshirë në shërbim. Në fakt, shërbimi ishte më i fuqishëm se sa shkollat e së dielës, studimet biblike, apo pjesëmarrja në adhurim, për zhvillimin e besimit të adoleshentëve."¹ A e kuptuat? Nëse duam që anëtarët e bashkësive tona të rriten si dishepuj, duhet t'i angazhojmë ata në shërbim.




Djali im dhe e shoqja kanë shërbyer në Kinë gjatë 8 viteve të fundit. Shumë studentë kinezë janë duke ardhur në besim. Im bir më ka thënë: “Çdo javë ne mbledhemi së bashku, para se të bëjmë studimin e Biblës, shkojmë dhe iu shërbejmë të varfërve apo emigrantëve në qytetin tonë për rreth gjysmë ore.” Kur e pyeta se pse, ai tha: “Të kujtohet si e mbylli tregimin e Tij mbi samaritanin Jezusi? ‘Shko dhe bëj dhe ti ashtu’ jo ‘shko dhe mendo dhe ti ashtu’. Është synimi ynë që të ndihmojmë njerëzit të bëhen si Jezusi. Unë nuk mund të dalloj nëse ata janë duke u bërë si Jezusi nga përgjigjet që më japin në studimin e Biblës, por mund të dalloj se po bëhen më shumë si Jezusi kur ata e japin veten për personat që nuk mund të bëjnë asgjë për t’ua shpërblyer atyre”.

3. Angazhimi jashtë mureve të kishës është diçka që njerëzit tuaj, si ndjekës të Krishtit, duan ta bëjnë vërtet.

Kur unë predikoj apo jap mësim, shpesh bëj pyetjen: “Sa prej jush këtu duan të ndryshojnë botën? Ngrini dorën”. Pa dallim, qoftë kur jam në kisha të mëdha apo në kisha të vogla, në kisha të reja apo të vjetra, padyshim që gati çdo dorë ngrihet lart. Të gjithë duan që të sjellin ndryshim. Askush nuk dëshiron të ndjehet sikur e ka jetuar jetën në kotësi.

Në të vërtetë, Perëndia ka vënë përjetësinë në zemrat tona. A mund të jetë kisha jote ai vend ku besimtarëve iu jepet rregullisht mundësia që të ndryshojnë botën në një mënyrë të tillë që diçka në botë të jetë ndryshe?



Prapë kthehemi tek Universiteti Baylor për anketimin e bërë. Në vitin 2007, studiuesit e Universitetit Baylor anketuan 50 bashkësi për të identifikuar jo më shumë se tre (nga 52 zgjedhjet) tema në të cilat “ju do të doni që kisha juaj të ndihmojë familjet tuaja dhe familjet e tjera”. Garland i përmbledh gjetjet e tyre: “Pothuaj pa përjashtim, në më shumë se 50 bashkësi që anketuam... ndihma në shërbim ndaj të tjerëve është nevoja e shprehur më shpesh në çdo bashkësi ... Çdo lloj familjeje kërkoi ndihmë për të shërbyer. Familje të rriturish të pamartuar e përmendën shumë më shpesh se sa gjëra të tilla si takimet e njohjes, përgatitja për martesë dhe romanca dhe seksualiteti në jetën prej beqari. Persona të divorcuar e kanë listuar këtë më shpesh se sa pajtimi dhe falja. Familjet e veja e kanë listuar atë më shumë se sa ndihma me ngushëllimin dhe trajtimin e krizës. Familjet që jetojnë me strese të mëdha (financiare,

shëndetësore, dhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin) prapë duan udhëzim për t’iu shërbyer të tjerëve.”²

Shumica e kishave kanë synime për çdo vit. Po sikur ju të hidhni sfidën që në fund të çdo viti çdo besimtar të ketë një histori për të treguar se si ai apo ajo kanë ndryshuar botën? Ne duhet ta përkufizojmë “ndryshimin e botës” sikur kupton: udhëheqjen e dikujt drejt Krishtit, ndihma që i jepet një fëmije të lexojë, ndihma që i jepet një nëne pa bashkëshort.

KTHIMI I PENGESAVE NË PIKA TË FORTA

Dalloni fuqinë e gjërave të vogla. Një gur i vogël i hedhur atje ku duhet, rrëzoi një gjigand. Më e vogla ndër farat, rritet për t’u bërë një pemë e fuqishme; pak maja ndryshon çdo gjë. ADN-ja e Jezusit është në çdo ndjekës të Krishtit, jo në një ndërtesë kisha. Vepra më e vogël misionare është kur një ndjekës i Jezusit përmbush nevojat e një tjetri me burimet që Perëndia i ka dhënë. Asnjë vepër nuk është tepër e vogël. Sa e vogël është një gotë ujë? Sa i vogël është një racion buke me peshk? Sa e vogël është një farë sinapi? Pjesë e punës së një pastori është që të ndihmojë në pajisjen e çdo shenjtori (qofshin 30 shenjtorë, apo

3,000 shenjtorë) për veprën e shërbimit (Efesianëve 4:11,12). Nënë Tereza na kujton se “nuk ka vepra të mëdha, vetëm vepra të vogla të bëra me një dashuri të madhe”.

Në qershor 2012, mora pjesë në Konferencën e Shërbyesve në Universitetin Hampton në reziden- cën studentore të Hamptonit, në

shtetin Virxhinia. mijëra pastore mbledhen në këtë mbledhje dhe festim njëjavor. Dr. David E. Goatly, drejtori ekzekutiv i Lott Carey International, hodhi disa pyetje sfiduese: “Po sikur t’i thonit njerëzve tuaj të dielën, ‘Mos hajdeni në kishë derisa të keni bekuar dikë’? Nuk ka kuptim që ne të bekojmë njerëzit thjesht për t’i bekuar ata. Ne i bekojmë njerëzit që edhe ata të bekojnë të tjerët”. Ai pastaj hodhi sfidën: “Po sikur të kishit njëqind persona në kishën tuaj dhe sikur secili prej tyre të dilte e të bekonte njerëzit gjatë një jave para rikthimit në kishë të dielën pasuese? Çfarë do të ndodhte në komunitetin tuaj dhe në kishën tuaj nëse do të pritej kjo gjë prej tyre?”. Po sikur ata 35 apo 50 apo 200 besimtarë të bënin të njëjtën gjë? Njëqind njerëz që bëjnë një vepër dashurie vetëm një herë në javë për një vit do të rezultonin në 5,200 vepra dashurie. Veprat e vogla të bëra me dashuri të madhe ndryshojnë gjithçka.

©2009 Paul F. Gray



Bibla thotë se Zoti e bën të bjerë shiun mbi të drejtët e të padrejtët. Po ti në cilët bën pjesë?

DISA FRUTA NË DEGËT E ULËTA

Fillojeni duke ndjekur zemrën e Perëndisë. Një vend i mirë për të filluar është vargu tek Letra e Jakobit 1:27 — “të vizitosh jetimët dhe të vejat në shtrëngimet e tyre.” Për një model të thjeshtë, shikoni Lëvizjen Njerëzit e Urdhërimit të Ri (New Commandment Men’s Ministries) në faqen e webit www.newcommandment.org. Ideja është e thjeshtë. Çdo kishë e çdo komunitet ka vejusha, nëna pa bashkëshortë, dhe njerëz që janë në vështirësi — përfshi dhe ata që i kanë bashkëshortët jashtë vendit apo në ushtri. Kisha i identifikon njerëzit në vështirësi dhe cakton skuadra prej tre apo katër njerëzish për çdo person. Një të shtunë në mëngjes çdo muaj burrat bëjnë një listë bazë punësh apo riparimesh që shumica prej nesh i bëjnë vetë në shtëpitë tona — rregullimi i rubinetave që pikojnë, lyerje të vogla, zëvendësimi i ndonjë rrjete, fshirje gjethesh, ndërrime llambash të djegura, etj. Pas disa orësh, burrat mbledhen dhe luten së bashku me personin për të cilin janë duke u kujdesur për ato nevoja apo kërkesa që ai ka. Mbi 600 kisha, përfshi timen, e kanë adoptuar këtë model. Nëse ju keni tre burra dhe një person në vështirësi në komunitetin tuaj, ju mund ta bëni këtë shërbim. Kjo është si rrotat e një valixheje. Pse u desh kaq shumë kohë për të shpikur diçka të tillë?

Fëmijët dhe shkollat. A e dinit që mësimi i leximit në nivelin e duhur kur fëmija përfundon klasën e tretë është një komponent shumë vendimtar për të ardhmen e atij fëmije? Një administrator më ka thënë: “Deri në klasën e tretë fëmijët *mësojnë të lexojnë*; pas klasës së tretë ata lexojnë për të mësuar.” Paaftësia për të lexuar në klasën e tretë lidhet me nivelin e braktisjes së shkollës, shtatzanitë adoleshente, përdorimin e drogës, varfërinë dhe burgosjet. Tetëdhjetë e pesë për qind e të burgosurve të mitur në SHBA janë analfabetë. Vetëm investimi i një ore në javë në shkollën fillore më të afërt mund të sjellë një ndryshim të madh. Shumë kisha punojnë nëpërmjet organizatës Shpresë për Fëmijët SHBA (Kids Hope USA) (www.kidshopeusa.org). Vetëm prania e një të rrituri që kujdeset, sjell përmirësim në rezultatet e provimeve tek fëmijët.

Po mësuesit? Me gjithë të ardhurat e vogla që kanë, mësuesit shpenzojnë mesatarisht mbi \$350 nga paratë e tyre për të blerë pajisje shkollore dhe materiale mësimore për nxënësit e tyre. Çfarë mund të bëjnë njerëzit e kishës suaj për të bekuar mësuesit në komunitetin që ju rrethon? Shumë njerëz, duke bërë secili një gjë të vogël, mund të sillnin një ndryshim të madh.

LIDHJA ME UNGJILLIZIMIN

Dashuria pa kushte, e shprehur me anë të një shërbimi të tillë, çon në biseda për Jezusin sepse njerëzit gjithmonë duan të dinë: “Kush je ti?” dhe “Përse po e bën këtë?” Veprat e mira krijojnë një vullnet të mirë dhe vullneti i mirë krijon mundësitë për të ndarë lajmin e mirë.

Kudo nëpër botë, njerëzit e gjejnë veten duke menduar ndryshe mbi atë që kisha mund të jetë dhe duhet të jetë. Ata e ndjejnë që, nëse një kishë nuk është duke shërbyer përtej anëtarëve të saj, nuk është në të vërtetë kisha për të cilën Jezusi e dha jetën e Tij. Nëse e gjen veten duke menduar, ky është kualifikimi yt për ta drejtuar kishën për të kaluar nga mirëmbajtja drejt misionit. Ju mund të mos jeni kisha më e mirë në komunitetin tuaj, por ju mund të bëheni kisha më e mirë për komunitetin tuaj.

Shënimet:

1. Diana R. Garland, *Family Ministry: A Comprehensive Guide* (Downers Grove, Illinois: Intervarsity Press, 2012), 641
2. Po aty, 639



ERIC SWANSON është një specialist misionesh në organizatën Rrjeti i Udhëheqësisë (Leadership Network; leadnet.org) dhe bashkë-autor i librave, *Kisha e Fokusuar së Jashtmi*, *Jeta e Fokusuar së Jashtmi*, *Kërkimi i Fokusuar së Jashtmi: Si të Bëheni Kisha më e Mirë PËR Komunitetin*, dhe *Për Transformimin e një Qyteti: Kisha e Plotë, Ungjilli i Plotë, Qyteti i Plotë*. www.ericjswanson.com

Nëse ëndrrat e mia në të vërtetë do të
vareshin nga zhytja e një topi
basketbolli, atëherë më prisnin vetëm
makthe dhe zhgënjime përpara...

Mendësia Po:

Si të Udhëheqësh
Me Anë të Aftësive,
Jo të Dobësive të Tua



Shumë pastorë janë
përballur me
kufizimet e
rrethanave ku
ndodhen aq shpesh,
saqë një mendësi
“unë s’mundem” i
gjymton mendimet e
tyre. A është e thënë
të jetë kjo fatkeqësia
e një bashkësie të
vogël?

Nga: MICHAEL CLARENSAU

U në kisha shumë dëshirë të zhysja në
kosh një top basketbolli.

Mbasi shihja

me orë të tëra lojtarët Julius Erving

dhe Kareem Abdul-Jabbar — yjet e fëmijërisë sime — që jepnin prova që zhytja e topave në basketboll hapte rrugën drejt famës në atletikë, u binda që aftësia për të luajtur mbi nivelin e koshit do të më jepte mua atë vend të çmuar në skuadrën time të shkollës së mesme. Kështu që kaloja orë të tëra duke u hedhur përpjetë. Nuk mund të futesha në një dhomë pa provuar për të parë nëse mund të prekja tavanin me dorë duke u hedhur. Ushtroja gishtat, duke u përpjekur t’i hapja ata në sipërfaqen e duhur për ta kapur një top basketbolli në mënyrë që të mundesha të realizoja synimet e mia akrobatike ajrore.

Fatkeqësisht, isha fëmija më shtatvogël në klasë. Edhe mbas orësh të tëra duke u kacavjerrë në paralelet e një parku aty afër duke u përpjekur që të zgjatesha ca, u bë e qartë që unë do të arrija maksimumi deri në 30 cm më pak nga synimi im për të qenë 210 cm i gjatë. Nëse ëndrrat e mia në të vërtetë do të vareshin nga zhytja e një topi basketbolli, atëherë më prisnin vetëm makthe dhe zhgënjime përpara. Me kalimin e kohës, realiteti zuri vend. Unë u përballa me përfundimin mizor që nuk mundesha, nuk e bëja dot dhe kurrë nuk do isha i aftë për ta bërë, zhytjen e topit në kosh.

Që në fillimet e shërbesës sime të parë si drejtues në kishë, (një koleksion i mrekullueshëm prej rreth 75 personash të shpenguar në një qytezë të vogël në Kansas) u përlesha me një zhgënjim tjetër të ngjashëm. Jo, skuadrës së basketbollit të kishës nuk i mungonte një lojtar sulmues; unë mund të kem qenë atleti më i mirë i bashkësisë. Por ne ishim shumë larg nga ku dëshiroja që të ishim, dhe ëndrrat e mia për kishën dukeshin po aq larg sa edhe 3 metrat nga buza e koshit të basketbollit.

Shkova në konferenca, por atje kishte Dr. J dhe Jabbar — apo barasvlerësit e tyre në rritjen e kishës — që e ngrinin standardin më lart nga sa mund të arrija unë. Këta udhëheqës jetonin në ajër të lartësisë mbi kokën time; dhe, megjithëse i admiroja arritjet e tyre dhe akoma ëndërroja të arrija të miat, e njihja grupin e miqve të mi adhurues dhe nuk mund të bëja shumicën e asaj që ishin duke bërë këta drejtues me famë.

Shumë pastorë kishash të vogla e njohin këtë ndjesi. Libra shumë të mirë dhe programe të ndryshme bëjnë thirrje nga faqet e katalogëve që ofrojnë shtigje për realizimin e ëndrrave tona apo shënime konferencash që premtojnë përgjigjet që ne dëshirojmë. Por kur shohim përbrenda, shpresat tona thërrmohen kur kuptojmë që nuk mundemi të bëjmë atë që autori këmbëngul se është e lehtë.

Shumë kishave të vogla iu mungojnë burimet njerëzore, burimet financiare, dhe aftësitë për të drejtuar shërbesa të caktuara, që thjesht ta marrin suksesin e parapaketuar të realitetit të dikujt tjetër dhe ta bëjnë atë që të funksionojë.



Ne realisht nuk mundemi. Shumë kishave të vogla iu mungojnë burimet njerëzore, burimet financiare, dhe aftësitë për të drejtuar shërbesa të caktuara në mënyrë që thjesht ta marrin suksesin e parapaketuar të realitetit të dikujt tjetër dhe ta bëjnë atë që të funksionojë. Ata nuk i kanë muzikantët për atë lloj muzike, as mësuesit për atë strategji dishepullizimi, dhe as njerëzit që të ndërmarrin atë projekt shërbimi apo paratë për t'i bërë gjërat në atë nivel. Ata thonë se nuk munden, dhe shumë herë kanë të drejtë.

Duhet t'ju tregoj se ia dola mbanë që të futem në skuadrën e basketbollit të shkollës së mesme. Kurrë nuk mësova të luaj dot mbi nivelin e koshit, por babai im më nxirrte jashtë te oborri dhe më mësoi se çfarë mund të bëja. Ai më mësoi të përvetësoj aftësitë e manovrimit të topit dhe mësova të dribloj shumë mirë. Madje mësova një lloj hedhjeje që krahët e mi të imët mund ta përballonin. Babai më ndihmoi që të zhvilloja disa aftësi që më çuan drejt pranimi në skuadër, duke luajtur në fushë, madje në anën fituese në më të shumtën e rasteve.

Shumë pastorë janë përballur me kufizimet e rrethanave të tyre aq shpesh sa që një "mendësi s'mundem" i gjymton mendimet e tyre (*Shih artikullin "Si Mund ta Di Nëse Kam Ngecur në 'Mendësinë S'Mundem' "*). A është e thënë të jetë kjo fatkeqësia e një bashkësie të vogël?

Nëse kapica e gjërave që nuk mund të bësh duket ca sfiduese, shikoni për një kapicë tjetër. Im atë ngulte këmbë se përgjigjet gjenden mes gjërave që ti mundesh të bësh. Për shumicën prej nesh, burimet tona të kufizuara duan të thonë se ato që s'mundem do vazhdojnë të jenë më të shumta se

ato që mundem, por ka një potencial të mahnitshëm kur rifokusojmë përpjekjet tona në atë që është realisht brenda mundësive tona.

Në librin e tij, *Now Discover Your Strengths [Tani Zbulo Aftësitë e Tua]*, autori Marcus Buckingham thekson keqkonceptimin e përhapur se potenciali më i madh për t'u rritur, qëndron në fushat e dobësive tona më të mëdha.¹ Ai argumenton që ne zor se do të kemi sukses duke u fokusuar në atë që nuk mund të bëjmë mirë, por një potencial i madh qëndron në energjinë që ne iu japim pikave tona të forta.

Gary McIntosh, autor i shumë materialeve për bashkësitë e vogla, afirmon një ide të ngjashme. Tek libri i tij *There's Hope for Your Church [Ka Shpresë për Kishën Tënde]*, McIntosh inkurajon pastorët që të shohin drejtimin e tyre mes gjërave që njerëzit e tyre mund t'i bëjnë mirë.² Në fakt, ai e shton zërin e tij ndaj shumë zërave të tjerë që tregojnë shtegun e mëposhtëm për zbulimin e shtegut unik të një kishë drejt shëndetit dhe rritjes.

PASIONI I DREJTUESIT

Zemra e drejtuesit është vendi i parë ku duhet kërkuar për atë që mund të bëjmë. Edhe pastorët janë njerëz, dhe zemrat e tyre ishin të mbushura me synime e pasione edhe përpara se të ndërmerrnin rolet që kanë në të tashmen. Një pastor ëndërron të shërojë njerëz të thyer sepse kjo është ajo që një kishë ka bërë për të në udhën e tij drejt Perëndisë. Një tjetër pastor nuk mundet veçse të vajojë mbi sfidat me të cilat përballen fëmijët dhe studentët. Ai ndjen një dëshirë të dëshpëruar që të sjellë një ndryshim në këtë brez që po rritet. Një tjetër zemër pastori kthehet drejt përqafimit të njerëzve që askush tjetër nuk do t'i prekte. Të tjerë nuk kanë gëzim më të madh se sa të shohin fuqinë jetë-ndryshese të Perëndisë në veprim përreth tyre.

Pas njëfarë kohe në shërbesë, pastorët kanë tendencën që të fokusohen më së shumti tek detyra. Ata jetojnë me kërkesat e përjavshme të shërbesës derisa vijnë në pikën kur mendojnë se pasioni i tyre i vërtetë qëndron në detyrat e shërbesës, si predikimi. Por pasioni i vërtetë është më thellë. Ndonjëherë ata mund ta gjejnë atë duke kujtuar: "çfarë ishin ata kur u thirrën" (1 Korintasve 1:26, NIV). Një rikthim tek pasioni që i çoi ata së pari drejt shërbesës mund të ndihmojë që t'u kujtojë atyre "përse"-në më të thellë në punën e tyre.

Pastorët nuk mund të drejtojnë në çdo drejtim të mundshëm; por, kur ata lëvizin në shtegun e pasionit të tyre, ata janë të pajisur në mënyrë unike për ta udhëhequr atë udhëtim. Ai pasion i dallon

ata nga udhëheqësit e tjerë, duke treguar që Perëndia e ka projektuar atë udhë unike që ata të ndjekin, një udhë ku ata mund të mobilizojnë personat të cilët udhëheqin drejt një impakti të mahnitshëm.

AFTËSIA E BASHKËSISË

Vendi i dytë ku duhet parë për të hedhur hapat e duhura përpara, është mes atyre gjërave që një bashkësi mund të bëjë mirë. Siç është vënë në dukje më parë, ka shumë gjëra që një bashkësi e vogël nuk mund t'i bëjë mirë. Por pavarësisht nga niveli i kufizimeve të saj, çdo kishë mund të bëjë diçka mirë.

Perëndia tregon një kreativitet të mahnitshëm në kishën e Tij. Ai shpërndan dhunti dhe talente në një mënyrë të tillë që shërbesa e çdo bashkësie të jetë unike. Ne thjesht nuk kemi të njëjtat aftësi në të njëjtat gjëra. Një bashkësi del se është efektive në shërbesën e saj të mësimi, dhe e provon atë aftësi me një shërbesë të fortë të Shkollës së të Dieles për fëmijët. Një tjetër kishë mund të jetë e bekuar me muzikantë që mund t'i sjellin një vibrato të veçantë shprehjes së saj të adhurimit. Një tjetër kishë ka një pasion për të shërbyer dhe kapacitetin për të gjetur mënyra krijuese për ta bërë këtë gjë.

Duket se sa më gjatë që të ekzistojë një kishë, aq më shumë shërbesa dhe programe do të ndërmarrë ajo. Energjia e bashkësisë dhe burimet e saj janë shpërndarë nëpër aktivitete të ndryshme, shumë prej të cilave janë filluar për shkak të pritjeve denominacionale apo suksesit të ndonjë kishe tjetër në këto shërbesa. Realisht, kisha e

vogël mund të jetë mjaft e prekshme ndaj *vizioneve kalimtare*. Vizioni kalimtar mund të jenë idetë e shërbesave që dikush sjell nga kisha e tyre e mëparshme në kishën e tyre të re. Ndërsa pastori dhe drejtuesit e kishës janë më të afrueshëm në një kishë më të vogël, njerëzit mund t'i flasin e t'ia mbushin mendjen për të filluar një shërbesë që ai anëtar i ri e ka përjetuar në një kishë tjetër. Kjo ndodh më shpesh në një kishë të cilës i mungon vizioni dhe drejtimi i qartë.

Rezultati më pas është akumulimi i programeve dhe shërbesave që vazhdimisht e pengojnë bashkësinë nga arritja e fokusit të duhur. Nuk është gjë e rrallë që bashkësia e vogël mund të veprojë në një shumëllojshmëri më të gjerë iniciativash dhe programesh në krahasim me sa do të gjenit në kalendarin e një kishe më të madhe.

Kur një bashkësi zbulon që mund t'ia dalë më së miri dhe fillon që të kanalizojë përpjekjet drejt një liste më të ngushtë aftësish, atëherë shpesh vjen vrulli. Njerëzit kënaqen duke bërë ato gjëra që ata mund të bëjnë me sukses dhe përpjekjet e tyre cilësore do të kenë një impakt shumë më të madh se sa ata mund të arrijnë në momentet kur dobësitë janë duke u shfaqur.

NEVOJA E KOMUNITETIT

Nevoja e komunitetit është vendi i tretë ku duhet parë për “mundësitë” e shërbesës. Ndërkohë që ka çështje që dalin në çdo qytet të madh apo të vogël, secili qytet ka gjithashtu nevoja që janë unike qoftë në natyrë apo në mprehtësinë e vet. Për shembull, një qytet i vogël mund të ketë një përqindje

Si Ta Di Nëse Kam Ngecur në Mendësinë s'Mundem



Shpesh herë një drejtues mund të jetë nga të fundit që e merr vesh se mendësia s'mundem ka zënë vend në mendimet e tij apo saj. Mbasi kam punuar me shumë pastorë dhe drejtues, shumë prej tyre tepër të irrituar, kam parë cilësitë e mëposhtme që kanë filluar të gjymtojnë kreativitetin dhe shpresën në ta.

PESE SHENJA TË MENDËSISË S'MUNDEM

1. Kur ti i përshëndet të rejat me kritikizëm. Drejtuesit e irrituar shpesh reagojnë ndaj sugjerimeve të të tjerëve me mendime fillestare negative. Edhe nëse zgjedhin më vonë që ta ndjekin atë ide, reagimi fillestar zbulon nivele të larta dyshimi.

2. Kur ti nuk iu zë besë suksesit të të tjerëve. Drejtuesit e irrituar mund të fillojnë të besojnë se sukcesi i të tjerëve do të vërë në dukje dështimet e atyre vetë. Pra, fitorja e dikujt tjetër më bën mua humbës. Shpeshherë këto ndjenja shprehen në kritikizëm ndaj të suksesshmit, ndoshta duke i akuzuar ata për kompromentim të vlerave themelore apo “mashttrim” në ndonjë formë tjetër.

3. Kur ke provuar *çdo mënyrë* dhe asgjë nuk funksionon. Ka raste kur flas me një drejtues që këmbëngul që ka provuar çdo gjë.

Në shumicën e rasteve, mund të mos ketë pasur mjetet për të provuar çdo gjë, por lodhja e tij me dështimin e çon të refuzojë çdo ide apo të imagjinojë se ka provuar gjëra që faktikisht nuk ka provuar kurrë t'i bëjë.

4. Kur je tërhequr nga drejtuesit e tjerë dhe nga mundësitë për inkurajim. Trishtueshëm, shumë drejtues që janë zënë në grackë në një mendësi “s'mundem” largohen nga miqtë në shërbesë apo pushojnë së ndjekuri takimet denominacionale ku mund të dëgjojnë për sukseset e të tjerëve apo të njihen me ide të tjera ndihmuese. Zakonisht ata ngulin këmbë që “Nuk ka më asgjë aty për mua” ose gjejnë një mënyrë për të kritikuar takimin për ta justifikuar mungesën e tyre.

5. Kur bashkësia juaj fillon që të jehojë të njejtin irritim. Fatkeqësisht, shumë drejtues të irrituar e përhapin virusin që ka vjedhur shpresën e tyre. Në rrethana të tilla, vullnetarët janë të shpejtë për të dhënë dorëheqjen, dhe anëtarët e stafit zhvillojnë të njejtin irritim të pastorit dhe kërkojnë për një shërbesë të re, duke ngulur këmbë që “nuk e durojnë dot më mënyrën se si janë këta njerëz.”

MICHAEL CLARENSAU, Springfield, Missouri

Si Ta

Mposhtësh

Mendësinë

s'Mundem



E vërteta është se pastorët e kyçur në mendësinë "s'mundem", ose do të fajësojnë veten, ose do të fajësojnë bashkësinë e tyre. Shumë persona do të heqin dorë ose do të krijojnë një mjedis të pashëndetshëm, që personat e rinj do ta shmangin duke u larguar.

Çfarë hapash mund të marrësh? Rruga e Eljas drejt rikthimit në shëndetin emocional ofron një shteg të dobishëm rimëkëmbjeje (1 Mbretërve 19).

1. Ha ushqime të shëndetshme dhe bëj ca pushim (vargu 6). Depresioni shpesh ndikon në regjimin e gjumit dhe të të ngrënit të shëndetshëm. Ti nuk je i pamposhtshëm. Kujdesu për trupin dhe do t'u japësh edhe mendimeve një shans më të madh për t'u shëndosur.

2. Kalo kohë vetëm me Perëndinë (vargjet 11–13). Elija kishte nevojë që të rikujtonte madhësitë e Perëndisë dhe të shihte që Ai ishte më i madh se sa kërcënim i pranishëm në

atë moment. Shpeshherë një pastor i irrituar ka nevojë për të njëjtin vizion. Ankesa plot keqardhje për veten si ajo e Eljas shkrin në fund nga rinovimi i thirrjes së Perëndisë në jetën e tij apo saj.

3. Kthehu nëpër rrugën nga erdhe (vargu 15). Elija duhej të pendohej për arratisjen e tij dhe të rikthehej në shinat e duhura. Ai u kthye nëpërmes vendeve nga ia kishte mbathur në irritim e sipër. Pastorët duhet të rivizitojnë gjërat që ata kanë thënë apo marrëdhëniet që mund të kenë dëmtuar në irritim e sipër, dhe të gjejnë e të sjellin një forcë të re në çdo situatë.

4. Ktheju punës (vargjet 16,17). Ashtu si Elija, Perëndia do t'i japë pastorit të rinovuar një ndjesi të qartë të detyrës që ka përpara. Në këtë fazë të rimëkëmbjes, pastori do ta shohë punën e tij me një sy të ri dhe do të shohë vlerë në ato vende ku irritimi i tij dikur ia kishte bllokuar pamjen.

MICHAEL CLARENSAU, Springfield, Missouri

jonormale të alkoolizimit apo kriminalitetit ndër të miturit. Nën at pa bashkëshortë mund të jenë të shumta, ose ndoshta një grup etnik në zgjerim e sipër mund të përbëjë një sfidë të re për komunitetin. Kur shërbesa e një kishe mund të vërë dorë në një boshllëk të rëndësishëm në komunitet, mundësitë do të krijohen.

Një vrull dhe një rritje e mahnitshme mund të ndodhë kur pasioni i pastorit, aftësitë e bashkësisë dhe nevojat e komunitetit shkrihen së bashku. Kombinimi i pasionit, aftësive, dhe nevojave mund të krijojnë një fokus shërbese që bëhet një "motor," që e çon kishën përpara, drejt një të ardhmeje përmbushëse.

Fatkeqësisht, shumë bashkësi më të vogla duken të vendosura që ta gjejnë suksesin e tyre në hijen e historive të suksesit të kishave të mëdha. Kështu ato hidhen në shërbesa të reja të cilave iu mungon kalibri dhe lidhja me komunitetin e momentit të tyre origjinal. Dhe sa më shpesh të provojë e të dështojë një kishë, aq më rezistues do të bëhen njerëzit e saj ndaj idesë tjetër të re që do hidhet.

DUKE SYNUAR JASHTË

Çdo kishë ka diçka që mund të bëjë mirë apo që mund të mësojë të bëjë mirë. Gjetja e një mënyre për ta përdorur jashtë atë aftësi, shpesh është hapi që mungon. Tepër shpesh një bashkësi e fokuson shërbesën e saj më efektive brenda për brenda, dhe komuniteti mund t'i përjetojë këto aftësi vetëm nëse zgjedhin të marrin pjesë në një shërbesë të së dielës.

Për shembull, supozojmë se një kishë ka një mësues të shkëlqyer Bible. Çdo të diel ai mësues ofron një nga mundësitë më të mira të mësimit në qytet, por të vetmit njerëz që do ta përjetojnë urtësinë e tij janë ata 12-15 persona që marrin pjesë në takim. Supozojmë se po ky mësues ndan veçmas çerekun e të dielave (13 javë) prej klasave të së dielës dhe gjatë atyre të dielave ofron një kurs 6-javor mbi prindërimin në qendrën më të afërt komunitare. Aftësitë e kishës do të ishin më të ekspozuara në komunitet dhe shërbesa e saj nuk do të ishte më e njëjta.

Shërbesa e shkëlqyer e fëmijëve në një kishë mund të përdorë një taktikë të ngjashme. Në komunitete të vogla, shkollat janë shpesh të hapura ndaj programeve me cilësi të lartë për një shfaqje gjatë orarit të shkollës apo pas këtij orari. Nëse ju dilni mirë të dielave, pse nuk e provoni edhe të hënave?

Më kujtohen përpjekjet e forta të bashkësisë sime të parë në shërbesat e fëmijëve. Ata po punonin shumë mirë, por vetëm pak familje dhe rreth 20 fëmijë në qytet kishin dijeni për to. Vetëm kur ne gjetëm një mënyrë për ta përdorur atë aftësi jashtë, kjo u bë një katalizator për rritje.

Kisha të tjera shkëlqejnë në muzikë. Ata mund të mos kenë burimet apo kapacitetet e produkteve të teknologjisë së lartë që ka një kishë më e madhe, por vendasit prapë mund të kënaqen me një koncert në park apo një skenë muzikore në ndonjë festë të përvitshme të qytetit. Shumë kisha e kanë parë që një koncert komunitar në ditën e

pavarësisë ka qenë një mënyrë më efektive për t'i lidhur me njerëz të rinj se sa duke dhënë shfaqjen tradicionale të Krishtlindjes në kishë.

Shumë kisha mund ta gjejnë këtë kapacitet për të shërbyer jashtë në komunitet. Një vit më parë, disa persona nga udhëheqësia e një kishë të vogël më thanë se ata ishin vërtet të aftë në organizimin e funeraleve. Në fillim pohimi i tyre m'u duk i çuditshëm, por së bashku ne zbuluam që përkujdesja e shkëlqyer e pastorit të tyre dhe mesazhet inkurajuese të tij të kombinuara me ushqimet e mrekullueshme që gratë e kishës dinin të përgatisnin, mund të ishin një mënyrë fenomenale për të ndikuar tek familjarët anëtarë të komunitetit të tyre që po përjetonin një periudhë të mbushur plot dhimbje. Pra, tani agjensia funerale lokale e di se mund të thërrasë këtë bashkësi të vogël sa herë që takojnë një familje në zi të cilës i mungon mbështetja e një kishë. Çfarë strategjie e mahnitshme për të ndikuar një komunitet.

Sigurisht, ka mënyra të shumta se si një kishë mund t'iu shërbejë fqinjëve të saj. Kuti me ushqime, rroba dhe ditë përkujdesjeje në ndihmë të prindërve të vetëm janë vetëm disa nga dhjetëra mënyrat se si një kishë mund të sjellë një ndryshim. Por, në vend që të bëjnë disa përpjekje të tilla njëkohësisht, kisha e vogël do të bënte mirë që të zgjidhte një ose dy mundësi ku ia del më mirë dhe të vazhdojë të gjejë mënyra për t'i bërë sa më mirë këto. Maksimizimi i aftësive është rruga drejt efektivitetit më të madh.

Për disa bashkësi, zbulimi i gjërave që ata mund të bëjnë mirë mund të përbëjë një sfidë për ta. Shumë kisha të vogla janë duke u plakur, dhe energjia për të shërbyer duket se nuk është më aq e disponueshme. Në raste të tilla, të mësosh t'i duash njerëzit dhe t'i duash siç duhet mund të jetë një alternativë e fortë. Nevoja për marrëdhënie është po aq e fortë sa më parë, prandaj kisha që vërtet i do njerëzit gjithmonë do të ketë një arsye që të ekzistojë.

Sigurisht, dashuria është mandati për çdo kishë, pavarësisht nga aftësitë e saj (Gjoni 13:35; 1 Korintasve 13:1). Ata që dështojnë të duan, kurrë nuk do të arrijnë që të ndërtojnë një kishë vërtet të shëndetshme, prandaj çdo bashkësi duhet ta numërojë këtë aftësi mes gjërave që ata bëjnë mirë.

ZGJIDHJA NDAJ IRRITIMIT

Këmbëngulja e Buckinghamit që funksionimi sipas pikave tona të forta modelon shtegun drejt efektshmërisë mund të jetë diçka çliuese për drejtuesit e bashkësive të vogla. Përpjekja për të zhvilluar shërbesa që të krahasohen me ata që

kanë më shumë burime e mban shumicën e drejtuesve në një gjendje inferioriteti emocional. Mendimet si *muzika te ne nuk do jetë kurrë si te ata ose, programi ynë për të rinjtë nuk do arrijë dot kurrë këtë bën* që ne të zhvlerësojmë muzikantët dhe programet rinore që kemi. Dhe kjo është receta për shumë momente të pashëndetshme.

Nëse çdo individ ka dhunti dhe aftësi unike me anë të të cilave ai apo ajo mund të forcojë kishën (Romakëve 12:6), atëherë ndodh që Perëndia e ka pajisur çdo bashkësi në mënyrën e vet unike. Zbulimi i këtyre aftësive dhe rritja e tyre në pika të forta ofron një shteg për shëndet dhe rritje që i përshtatet bashkësisë, dhe që mund ta vazhdojë në të ardhmen.

Përderisa roli i pastorit është që të pajisë njerëzit për shërbesat të cilat Perëndia i ka aftësuar ata të përmbushin (Efesianëve 4:13), atëherë të ndihmuarit e njerëzve që t'i gjejnë dhe t'i zhvillojnë ato dhunti mund të jetë një nga detyrat më primare e tij apo të saj.

PËRFUNDIM

Nëse babai im nuk do të më kishte mësuar që të bëja përpjekjet e mia më të mira për të hedhur një top basketbolli dhe ta hidhja sa më mirë, gerrat e shkollës së mesme që janë qëndisur në një xhakëtë të pluhurosur në dollapin tim do të ishin zëvendësuar vetëm me dëshira dhe 'po sikur'-e. Nuk është se u bëra ndonjëherë kërcënim për vendin e Dr. J-it në hollin e famës, por më shumë se 30 vjet më vonë akoma luaj disa net në javë. Kujtimet do të mjegulloheshin nga zhgënjimet, dhe mund të mos kisha arritur sigurinë për t'iu rënë pas aftësive mbi të cilat të ndërtoja të ardhmen time. Prandaj mos u varni më në kolovajzë duke ëndërruar ëndrrat e njerëzve të tjerë. Jepini energjinë tuaj më të mirë pikave më të forta që keni, dhe do të shikoni se bashkësia juaj do të bëhet ajo që Perëndia e ka planifikuar të jetë.

Shënimet

1. Marcus Buckingham dhe Donald O. Clifton, *Now Discover Your Strengths [Tani Zbulo Aftësitë e Tua]* (New York: The Free Press, 2001), 7.
2. Gary L. McIntosh, *There's Hope for Your Church: First Steps to Restoring Health and Growth [Ka Shpresë për Kishën Tënde: Pesë Hapa për Përtëritjen e Shëndetit dhe Rritjes]* (Grand Rapids: Baker Books, 2012), 75.



MICHAEL CLARENSAU, drejtor kryesor, Healthy Church Network (Rrjeti i Kishave të Shëndetshme), Springfield, Missouri.

Pastorimi Emocionalisht i Shëndetshëm

Ruajtja e shëndetit emocional në shërbesë fillon duke u përballur me të vërtetën e rrëmuqshme e të dhimbshme të ballafaqimit me mënyrën si jemi duke ia dalë në tri fusha kryesore të jetës dhe shërbesës.

Nga: **PETE SCAZZERO**



P

as 20 vjetësh si pastor kryesor, më në fund

e pranova që kam qenë duke kaluar përciptas shumë gjëra në mënyrën si kam udhëhequr.

Kjo është mënyra se si shumë prej nesh

përballojmë detyrat e shumëfishta, presionin e

vazhdueshëm dhe axhendat e mbingarkuara. Ne mbulojmë

shumë terren në mënyrë sipërfaqësore, por nuk merremi në

mënyrë të thellë me rrethinat tona. Ashtu si në rastin kur

kalohet përciptas një libër, kjo gjë mund të prodhojë

përshtypjen që ke mbuluar çdo gjë; por në realitet, nuk je

plotësisht në brendësi.

Si mund ta dish që je duke kaluar përciptas?

- ▶ Kur je duke shkuar nga një takim në tjetrin pa pasur ndjesinë e Perëndisë.
- ▶ Kur u thua po angazhimeve dhe zgjerimeve të reja pa ndjekur siç duhet ato që i ke marrë përsipër për të bërë tashmë.
- ▶ Kur kupton se nuk ke marrë kohë të mjaftueshme për ta lejuar të vërtetën e asaj që je duke predikuar që ta transformojë ecjen tënde me Krishtin.
- ▶ Kur ti i shmang vendimet dhe të vërtetat e vështira për shkak se do të zemëroje dikë.
- ▶ Kur merresh me një telefonatë apo vizitë pastorale, por e bën me bezdi këtë gjë.
- ▶ Kur nuk pushon dot së menduari për ndonjë punë të papërfunduar në kishë ndërsa je me familjen.
- ▶ Kur je tepër i zënë për të reflektuar mbi zemrën tënde apo për të kultivuar marrëdhënien tënde me Jezus Krishtin.
- ▶ Kur nuk je duke investuar në rritjen tënde personale apo në forcimin e martesës tënde.
- ▶ Kur e mat suksesin tënd duke u bazuar mbi atë çfarë thonë njerëzit e tjerë në vend të vlerave të brendshme përpara Perëndisë.

Shumë herë kalimi i përciptë është një mekanizëm mohimi që na bllokoi që të rritemi frymërisht dhe emocionalisht. Është një mënyrë për të shmangur aspekte të shërbesës që shkaktojnë ankth apo dhimbje të mundshme. Kjo mund të funksionojë për një kohë, por me kalimin e kohës na mbërthen, dhe atëherë ka një çmim që duhet paguar. Ja se si më

të gjejmë mënyra se si të sigurojmë një drejtim administrativ krahas rolit tim si pastor. Çdo herë sikur përplaseshim me një mur. Asgjë nuk funksiononte në afat të gjatë. Ky ishte problem kur kisha ishte njëvjeçare dhe mbeti problem edhe kur u bë njëzetvjeçare. Çështja nuk qëndronte te madhësia, por brenda meje.

E megjithatë unë vazhdova që të shmangia vendimet e vështira, menaxhimin e vullnetarëve të rëndësishëm, caktimin e një kohe për planifikimin e takimeve, apo marrjen me detajet e projekteve.

I shikoja qartë gjërat që kishim nevojë të bënim, por doja që t'i bënte dikush tjetër. *Kjo është e gjitha punë administrative, i thoja vetes. Është një punë që duhet ta bëjë tjetërkush. Nuk më përshtatet fare.*

Duke kthyer shikimin pas, mund të shoh dy faktorë që më pengonin.

Nuk kisha besim tek vetja. Përgjatë shërbesës sime kam pasur shumë dështime administrative, dhe kisha ndjenja të përziera në lidhje me të provuarit përsëri. Plus, pastorë të tjerë, madje dhe gruaja ime më thanë: "Ti nuk i ke këto dhunti, kështu që përdor pikat e tua të forta dhe gjej të tjerë që të të plotësojnë aty ku je dobët. Kaloje kohën tënde me Fjalën dhe në lutje. Le ta administrojnë të tjerët kishën." Kjo e përforcoi bllokun tim mendor që unë nuk mundesha ta bëja këtë.

Isha frikacak. Çdo herë që shihja se çfarë duhej bërë, kisha frikë t'i hyja angarisë. Kishim nevojë të bënim ndryshime në udhëheqësi. Nuk kishim vendosur në vendet e duhura disa njerëz kyçë. Të

Është iluzion të imagjinojmë se mund t'i udhëheqim njerëzit tanë në një udhëtim frymëror që ne vetë nuk e kemi bërë.



mbërtheu mua dhe më detyroi që të merrem me këto kalime përciptazi.

Prej vitesh anëtarët e këshillit drejtues të kishës sonë, në rishikimin vjetor të rolit tim, më pyesnin se sa i kënaqur isha me rolin tim si pastor kryesor.

"Më pëlqen të predikoj, të jap mësim, të hedh vizionin, dhe të dishepullizoj njerëzit", iu përgjigjesha. "Por Perëndia nuk më ka dhënë dhunti për të bërë punë administrative apo të menaxhoj organizatën. Administrimi më acaron."

Prej vitesh, unë dhe këshilli drejtues, jemi përpjekur

tjerë nuk po i përmbushnin siç duhet rolet e tyre. Dhe kjo tashmë ishte duke pasur një ndikim gjithnjë e më të madh në kishë.

Kisha marrë vendime të vështira edhe përpara kësaj, por tani isha duke e shmangur këtë, në përpjekje për të qëndruar jashtë telasheve, në sigurinë time, përtej çështjeve administrative që po na rëndonin.

Ç'është e vërteta, kisha frikë se njerëzit do të më keqkuptonin, se do të humbisja miqësira, dhe njerëzit do të largoheshin nga kisha, duke na e prerë hovin.

Ankohesha. U zemërova. Fajësoja. Vara turinjtë. Por nuk bëra asgjë.

GJETJA E INTEGRITETIT TIM PERSONAL — MË NË FUND

Më në fund një seri ngjarjesh u bënë bashkë për ta thyer atë guaskë në të cilën isha mbledhur.

Së pari, arrita një pikë irritimi në maksimum. Funksionimi i brendshëm i udhëheqjes së kishës sonë nuk reflektonte mesazhin që unë isha duke predikuar. Nuk mund të predikoja më një mënyrë të jetuari që ne vetë nuk po e jetonim.

Rreth kësaj kohe, gruaja ime, Geri, më foli: “Pit, mendoj se çështja është kurajoja, kurajoja jote. Nuk po të fajësoj ty. Është e vështirë të bësh ato lloj ndryshimesh që duhen bërë. Gjithçka që di është që ti je në pozicionin për t’i bërë, por nuk je duke i bërë. Në marrëdhëniet me stafin, ti nuk je duke i përdorur në masën e duhur vlerat tona të përshtatshme emocionale të shëndetshme. Je i zemëruar dhe gjithë mlllef. Ne kemi një kishë të mrekullueshme por...”

Ajo bëri një ndalesë e pastaj e hodhi bombën. “Ka të bëjë me ty. Mund të mos kesh dhuntinë e nevojshme për të bërë çfarë duhet bërë. Ndoshta koha jote ka përfunduar dhe dikush tjetër duhet të ngrihet e të marrë drejtimin.”

Ajo më ekspozoi. Ndërkohë që fjalët e saj më shkaktoan dhimbje, e dija që ishin të vërteta. E kalova ditën që pasoi vetëm me Perëndinë dhe me ditarin tim.

Po, doja që dikush tjetër të vinte e të vendoste rregull në shtëpi, të drejtonte kishën dhe ndryshimin e dhimbshëm që kishim përpara. Por tani u bë e qartë. E pranova të vërtetën: Penguesi më i madh që kisha Jeta e Re (New Life Fellowship Church) të arrinte të bëhej ajo që Perëndia dëshironte që të bëhej, isha unë, jo një person apo faktor tjetër.

Gjatë vitit pasues mësova që aftësitë për të bërë punët ekzekutive të një organizate nuk janë të vështira për t’u zhvilluar. Vështirësia reale ishte që të gjeje kohën, duke menduar me kujdes përpara Zotit, duke mbledhur kurajën për të bërë bisedat e vështira, dhe duke i çuar gjërat deri në fund. Tani isha duke iu futur të vërtetës së vështirë dhe të dhimbshme që do të na çlironte si mua, ashtu edhe gjithë kishën.

SHËNDETI EMOCIONAL NË KISHË

Ndërkohë që moskalimi përceptas i çështjeve në udhëheqjen time u bë një mësim i madh për mua, pyesja veten se edhe sa gjëra të tjera ishin duke u

kaluar në këtë mënyrë në fusha të tjera të jetës sime. Ti mund të kalosh përceptas pazaret për dhurata Krishtlindjesh dhe pastrimin e makinës. Mund të kalosh përceptas jetën tënde sociale, emaillet e tua, dhe listën e leximeve. Por mos i kalo përceptas gjërat që janë tepër të rëndësishme.

Unë u bëra i vetëdijshëm për tundimin tim që t’i kaloja përceptas gjërat në tri fusha në jetën time. Secila kishte pasoja të thella dhe tepër ndikuese, për veten time dhe për njerëzit të cilëve iu shërbeja. Po këto tri fusha janë të aplikueshme nëse kisha jote është me 30, 50, 100, ose 1,000 anëtarë. Drejtimi i vetes tënde është gjithmonë sfida më e madhe.

MARRËDHËNIA JOTE ME PERËNDINË


Kultivimi i një jete me Jezusin kërkon segmente të mëdha kohe të fokusuar. Ditët e tëra vetëm me Perëndinë, orët e meditimit mbi Shkrimet, dhe kohët e leximit janë të pazëvendësueshme. Jemi të rrethuar nga shpërqendrimet e pafundme dhe zërat që na thërrasin larg nga të ulurit te këmbët e Jezusit, siç bëri Maria tek Luka 10:38–42.

Përgjatë historisë së kishës, një nga shtatë mëkatet vdekjeprurëse është plogështia (*acedia*, “moskokëçarja”), që përshkruan jo thjesht përtacinë, por të zënit e kohës me gjëra të gabuara. Ne jemi të zënë, u përgjigjen drejtuesit frymërorë, sepse nuk mund të përballojmë mundimin që kërkon një jetë meditimi dhe vetmie me Perëndinë. Nuk ka durim për aktivizëm, dhe për aktivitet të perëndishëm, nëse këto nuk janë të ushqyera nga një jetë e brendshme e pasur me Perëndinë.

Etërit e Shkretëtirës në mënyrë të përsëritur kanë paralajmëruar për angazhimin në aktivitete për Perëndinë para se të ketë ardhur koha e duhur. Ata na ofrojnë një paralajmërim shumë aktual.

Pra, me qëllim që të ndaloja të kaluarit përceptas të marrëdhënies time me Perëndinë, fillova që të ndërtoja ritme manastiri në jetën time. Për shembull, fillova të praktikoj udhëtime të përditshme tek zyra si një mënyrë për të strukturuar ditët e mia. Fillova të planifikoj çdo ditë tre apo katër blloqe kohore për t’u ndalur, përqendruar, lexuar Shkrimet, e për të qëndruar në heshtje. Gjithashtu u bëra kategorik për ditët e heshtjes si elemente të pazëvendësueshme të thirrjes sime si pastor.

Është iluzion të imagjinojmë se mund t’i udhëheqim njerëzit tanë në një udhëtim frymëror që ne vetë nuk e kemi bërë. Asnjë program nuk mund të shmangë përceptësinë dhe vetë-mjaftueshmërinë që do të përshkojnë shërbesën tonë në qoftë se e kalojmë përceptas marrëdhënien tonë me



Pjesë e arsyes se pse i anashkaloja disa gjëra në udhëheqjen time është fakti që bëja një ndarje mes asaj që është laike dhe e shenjtë.

Perëndinë. Imagjinoni sikur Dymbëdhjetë Dishepujt të kishin lejuar veten që të shpërqendroheshin nga Fjala e Perëndisë dhe lutja në Veprat 6.

MARRËDHËNIA JUAJ ME VETEN

Shumica prej nesh jemi të mbingarkuar dhe të preokupuar. Jemi të uritur për kohë dhe të rraskapitur nga nevojat e pafundme rreth e qark nesh. Kush ka kohë të kënaqet në Jezusin, me gratë dhe fëmijët tanë, dhe me vetë jetën?

Ne mendojmë se do ta kompensojmë më vonë gjumin tonë. Hamendësojmë që hapësira për të cilën kemi nevojë për të rikarikuar shpirtin tonë dhe për t'u relaksuar mund të ndodhë më vonë. Pak prej nesh kemi kohë për t'u zbavitur dhe për hobi. Thjesht ka shumë punë që duhet të bëjmë për Zotin.

Jezusi është modeli për ne për mënyrën se si të kemi një kujdes të shëndetshëm për veten. Me peshën e gjithë botës mbi supe, ne vëmë re se Ai pushon dhe kënaqet me atë që i sjellin të tjerët përpara se të shkojë në kryq (Gjoni 12:1–8).

Bernardi i Klervosë, ashtu si Agustini përpara tij, dalluan që dashuria e pjekur nuk ekziston pa pasur një bazë dashurie për veten. Nëse nuk dimë se çfarë është përkujdesja për veten, nuk mund t'i duam siç duhet të tjerët. Vetëm nën dritën e dashurisë së Perëndisë mund t'i duam siç duhet të tjerët. Bernardi madje argumenton që dashuria për veten për hir të Perëndisë është forma më e lartë e dashurisë për Perëndinë. Detyrimet pa pushim mund të shkatërrojnë gëzimin e Zotit, që është forca jonë.

Një çelës për lirinë tonë është rizbulimi i respektimit të Shabatit, një praktikë formimi frymëror e cila është radikale dhe kundër kulturës. Unë e pranoj ftesën e Perëndisë për të ndalur, pushuar, kënaqur, dhe soditur Atë për një periudhë prej 24-orësh. Për mua, kjo do të thotë të ndalem të premten në 7 të mbrëmjes, deri të shtunën në 7 të mbrëmjes—edhe nëse nuk kam përfunduar predikimin. Unë i them stop të gjitha “duhet të”-ve. E shmang kompjuterin, emailin, dhe punët që kanë të bëjnë me kishën. I kaloj të shtunat duke bërë punë të tjera, si për shembull pastrimi i shtëpisë, riparime te makina, larje rrobash dhe pagesa faturash.

Shabati na bën thirrje që të planifikojmë në axhendat tona çdo javë edhe kohë kur nuk bëjmë asgjë. Nuk arrijmë asgjë që të jetë e matshme, pra. Sipas standardit të botës, kjo nuk është aspak efektive, është joproduktive dhe e kotë. E megjithatë është një nga elementët më themelorë që Perëndia na ka dhënë që të mund të kujdesemi për veten.

TI DHE MARTESA JOTE (NËSE JE I MARTUAR)

Pak veta kanë dëshirë të pranojnë gjendjen e trishtueshme të martesave të shumë pastorëve. Ta pranosh këtë gjë ka mundësi që të ndërpresë, të paktën për një kohë të shkurtër, disa nga kishat tona që kanë ritmin më të lartë të rritjes.

Konferencat më të mira të udhëheqësisë dhe ato denominacionale, së bashku me seminarët dhe shkollat tona, nuk na trainojnë se si të kemi martesë që zgjasin dhe që synojnë drejt qiellit. Ne i shpërfillim presionet unike të shërbesës, duke menduar gabimisht që një martesë e suksesshme do të ndodhë natyrshëm nëse punojmë për Zotin.

Ne harrojmë parimin biblik: “ashtu siç shkon martesë e drejtuesit, ashtu do të shkojë dhe kisha.” Nëse jemi duke kaluar përciptas në shtëpi, nuk do të jemi të aftë që të udhëheqim një familje kishe të shëndetshme (1 Timoteut 3:5).

Nëse je i martuar, bashkëshortja jote vjen e para, dhe fëmijët që ju ka dhënë Perëndia. Kjo besëlidhje merr përparësi mbi kishën dhe njerëzit e tjerë.

Pali i referohet bashkimit në një mish të burrit dhe gruas si një model i bashkimit të Krishtit me nusen e Tij, Kishën (Efesianëve 5:31,32). Për këtë arsye, Perëndia ka krijuar martesën dhe seksualitetin tonë që të shpallin dhe pasqyrojnë bashkimin tonë me Krishtin. Bashkimi ynë martesor duhet të jetë një tablo dhe përvojë e marrjes dhe dhënies së dashurisë së Perëndisë. Kush ka kohë të investojë në një udhëtim të tillë mësimor rritjeje?

Disa pastorë do të thonë: “Pit, a do të kërkojë kjo një ndryshim në gjithë mënyrën si unë i bëj shërbesat?” Po.

Geri dhe unë bëmë një përkushtim 19 vite më parë që investimi në martesën tonë do të ishte prioriteti më i lartë i jetëve tona pas Krishtit. Kalendarin ynë



filloi ta pasqyrojë atë ndryshim. Ne planifikuam kohë ekskluzive e të pandërprerë çdo ditë dhe javë për të qenë plotësisht prezent me njëri-tjetrin. Dhe ne filluam që të kalojmë rregullisht diku afër net dhe mëngjese për t'u shkëputur nga rutina.

Sigurisht, tundimi për të kaluar përciptas disa gjëra që i përkasin martesës sonë mbetet. Por ndërsa teologjia jonë e martesës si një thirrje, si një shërbesë dhe mision specifik nga Perëndia, është thelluar me kalimin e viteve, kjo ka bërë që tundimi për të kaluar përciptas të dobësohet.

TI DHE UDHËHEQJA JOTE

Pjesë e arsyes se pse i anashkaloja disa gjëra në udhëheqjen time është fakti që bëja një ndarje mes çfarë është laike dhe çfarë është e shenjtë, duke i trajtuar funksionet planifikuese të udhëheqjes pastorale si më pak të rëndësishme dhe më pak domethënëse sesa lutja dhe studimi i Biblës.

Prej vitesh kam preferuar të bëj gjërat e lehta dhe jo gjërat e nevojshme. Nuk më pëlqen konflikti dhe tensioni. E kujt i pëlqejnë?

Kur ndalova së kaluari përciptas, fillova të shoh se sa shumë varej jeta ime nga vlerësimi i jashtëm.

Doja që njerëzit të më thonin që isha në rregull. Zbulova që njerëzit nuk afroheshin drejt meje pas bisedave të vështira; përkundrazi distancoheshin prej meje.

Ndonjëherë i shmangia takimet që e dija që do ishin të vështira. I bija përciptas të vërtetave që ishin të parehatshme. Preferoja që të mos bëja pyetje të vështira e të mos flisja kur diçka qartësisht nuk shkonte.

Është më e lehtë të nxitosh në një takim pa planifikuar. Është më e vështirë që të kalosh kohën e nevojshme për të qartësuar synimet dhe axhendat tona.

Është më e lehtë të jesh reagues sesa meditues dhe një njeri që kalon kohë të mjaftueshme në lutje. Më duhet ta pranoj që i kisha bazuar shumicën e vendimeve të mia mbi ndjesitë dhe impulset. Kur e bëja këtë, ishte e vështirë që të siguroja një udhëheqje të matur.

Është e lehtë të thuash një gjë e të bësh një tjetër. Është e vështirë që të mbetesh i përqendruar dhe besnik ndaj përkushtimeve.

Është e lehtë t'u japësh një lustër mospërpjethjeve. Është e vështirë që të shqyrtosh faktet e dhimbshme që gjërat mund të mos jenë duke shkuar mirë.

Është e lehtë të angazhohesh në një paqe të rreme duke i qetësuar njerëzit. Është e vështirë ta thuash të vërtetën kur ata mund të inatosen.

Është e lehtë t'i justifikosh zellin dhe ekzagjerimet tona si vizion. Është e vështirë që ta ndërthurësh besimin me fakte solide.

Ne kemi nevojë që të kujtojmë synimin tonë — transformimi i njerëzve në ngjashmërinë me Krishtin. T'i duash njerëzit nuk do të thotë t'i mbash ata të lumtur. Jezusi na tregon me shembullin e tij se lëndimi i njerëzve është shpeshherë pjesë e të ndihmuarit të tyre për të arritur në pjekuri.

Dhe mbani mend: udhëheqja që nuk kalon përciptas na çliron ne dhe njerëzit tanë — edhe nëse do të shkaktojë dhimbje më parë.



PETE SCAZZERO është pastor kryesor i kishës New Life Fellowship në Queens, New York, dhe autor i dy librave: *The Emotionally Healthy Church* [Kisha Emocionalisht e Shëndetshme] dhe *Emotionally Healthy Spirituality* [Përshpirtshmëria Emocionalisht e Shëndetshme]. Vizitojeni Pitin në faqen: www.facebook.com/petescazzero, dhe www.emotionallyhealthy.org.

"Por për njeriun nuk u gjend asnjë ndihmë e përshtatshme për të. Atëherë Zoti Perëndi e futi në një gjumë të thellë njeriun, të cilin e zuri gjumi; dhe mori një nga brinjët e tij dhe e mbylli mishin në atë vend. Pastaj Zoti Perëndi me brinjën që i kishte hequr njeriut formoi një grua dhe e çoi te njeriu. Dhe njeriu tha: 'Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri.'"
(Zanafilla 2:23).

BRINJA e ADAMIT

Nga MARCIA LEDNICKY

Shumë libra janë shkruar në lidhje me marrëdhënien e gruas me burrin e saj.

Megjithatë, roli i *gruas së një shërbyesi* është unik.

Prandaj, në këtë artikull dhe në disa të tjerë që do të pasojnë, do të kemi synim që ta shqyrtojmë këtë rol shumë të veçantë të bashkëshortes së shërbyesit dhe si mund ta përmbushë ajo vendin e saj të shërbesës, dhënë nga Perëndia.

QËLLIMI I PERËNDISË PËR KRIJIMIN E NJË "NDIHME QË LEVERDIS" PËR ADAMIN

Ndoshta vendi më i mirë nga mund të fillojmë është që të përpiqemi të kuptojmë se çfarë synon të thotë Shkrimi mbi qëllimin e Perëndisë në krijimin e një "ndihme që leverdis" për burrin e parë, Adamin.

Zanafilla 2:18: "Pastaj Zoti Perëndi tha: 'Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; unë do t'i bëj një ndihmë që i leverdis.'" Fjala "ndihmë" nuk është një term zhvleftësues; ai shpesh përdoret të Shkrimet për të përshkruar Perëndinë e Plotfuqishëm. Në fakt, në Letrën Drejtuar Hebrenjve 13:6 thuhet: "Perëndia është ndihmuesi im dhe unë nuk do të kem frikë; ç'do të më bëjë njeriu?" Përkufizimi hebraik i fjalës ndihmues është "dikush që i del në krah dikujt tjetër për të arritur përmbushje të plotë."

Perëndia bëri Evën dhe zuri fill një partneritet.

- * Gruaja u krijua si një plotësim për burrin, pjesë integrale e burrit dhe një partner me influencë për burrin.
- * Si një partnere me burrin, gruaja nuk ka zotërim mbi burrin, por secili i shton plotësisë së tjetrit duke përmbushur detyrat e tyre, të dhëna nga Perëndia.
- * Kur Perëndia krijoi burrin, dhe nga burri krijoi gruan, ai bëri një bashkim ku ti gjen mikun tënd më të ngushtë, dashurinë e pashoqe, të besuarin më të madh, dhe partnerin e jetës.

Kur shpjegon këtë varg, predikuesi i famshëm anglez, Matthew Henry, dikur ka shkruar:

“ Gruaja u bë nga një brinjë nga ija e Adamit; nuk u bë nga koka e tij që të sundonte mbi të, as nga këmbët e tij që të shkelej prej tij, por nga ija e tij që të jetë e barabartë me të, nën krahun e tij që të ishte e mbrojtur, dhe pranë zemrës së tij për t’u dashuruar. ”

Gjatë kohës së Krishtit, gratë ishin shumë të përfshira në punën e Zotit në mënyra të ndryshme e tepër të rëndësishme.

- * Gratë ishin **të fundit** që u larguan nga vendi i kryqëzimit të Krishtit (Marku 15:47)
- * **Të parat** që shkuan për të parë Varrin (Gjoni 20:1)
- * **Të parat** që shpallën ringjalljen (Mateu 28:8)
- * Morën pjesë në takimin **e parë** të lutjes (Veprat 1:14)
- * **Të parat** që i përshëndetën misionarët Pal dhe Sila, në Filipi (Veprat 16:13)
- * E konvertuara **e parë** në Europë (Lidia) (Veprat 16:14)

PARIME BAZË PËR NJË SHËRBESË EFEKTIVE NDAJ MËSUESIT

Le të fillojmë me disa parime themelore që do të na shërbejnë si udhërrëfyes për t’u bërë sa më efektivë në shërbesën ndaj Mësuesit.

Çfarë do të bënit ju të dy së bashku me thirrjen që ju ka dhënë Perëndia? Dy jetë, plotësisht të përkushtuara ndaj planit dhe qëllimeve të Perëndisë. Dhe, meqenëse nuk mund të gjejmë një fjalë më të përshtatshme, cili është “roli” yt në këtë partneritet? Në disa martesa, të dy, si burri edhe gruaja kanë marrë thirrjen nga Perëndia për një shërbesë predikimi. Megjithatë, në shumë raste, gruaja shërben si një ndihmëse për burrin e saj, por nuk është thirrur për një “shërbesë në podium.” Kjo shpeshherë çon në një diskutim interesant: “Im shoq është thirrur për shërbesë, jo unë!”

Më lejoni që të marr një moment për t’ju treguar pak për veten time. Unë kam qenë e bekuar që kam lindur në familjen e një pastori. Prindërit e mi e donin Zotin, punonin me dashuri për Të, dhe i donin njerëzit. Unë falenderoj Perëndinë për trashëgiminë e mrekullueshme që Ai më ka dhënë. Unë nuk u thirra për të “shërbyer në podium”, por u martova me një shërbyes dhe së bashku kemi përmbushur, dhe mund të shtoj se jemi akoma

duke u përpjekur që të përmbushim thirrjen e Perëndisë në jetët tona. E dua shërbesën; është jeta ime. Kam shërbyer si grua pastori, kam dhënë mësim në klasa për gra pastorësh dhe gra të ardhshme pastorësh në Kolegjin Biblik, dhe kam shërbyer në shumë konferenca për gratë e shërbyesve. Perëndia ka hapur shumë dyer mundësish për mua që të ndaj me të tjerët Fjalën e Tij, dhe të flas për besnikërinë e Tij drejtuar atyre që janë ndjekës të Tij. Me një masë të madhe lutjesh këmbëngulëse, kam ecur përmes atyre dyerve të hapura dhe kam lejuar Perëndinë që të më përdorë në çfarëdo mënyre që Ai dëshironte të më përdorte. Por, në secilin vend shërbese, më është dashur që të përshtatem. U bë e nevojshme që të gjeja vendin tim të veçantë të shërbesës në secilën kishë ku kemi shërbyer si pastorë, në kolegji si grua e presidentit të kolegjit, si bashkëshorte në përgjegjësitë e udhëheqjes së Departamentit Denominacional dhe Kombëtar, dhe si grua misionari. Ku e kam vendin unë? Si mund të më përdorë më mirë Perëndia? Këto janë pyetje të rëndësishme që një partner në shërbesë duhet t’ia bëjë shpesh vetes. Pjesa e bukur është që ne i shërbejmë një Perëndie që është besnik dhe që sheh zemrat tona dhe e njeh dëshirën tonë për t’i shërbyer Atij. Ka gjithmonë një vend shërbimi për shërbëtorin me një zemër të gatshme dhe të bindur.

Do të ketë raste kur mund të ndjeheni e pakualifikuar, por Perëndia kurrë nuk do t’ju kërkojë të bëni diçka për të cilën nuk do t’ju pajisë për të bërë. Besojini atij për udhëzim dhe drejtim në çdo vend që shërbeni.

“Fuqia e tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë, me anë të njohjes së Atij që na thirri me lavdinë dhe virtytën e vet.” (2 Pjet. 1:3)

Kur ju e pranoni thirrjen e Perëndisë për t’i shërbyer Atij, duhet të merrni mbi vete edhe përgjegjësi të tjera. Për shembull:

- * **Të identifikoheni me problemet e njerëzve të tjerë në kishën tuaj.** Mbani mend që ata janë delet tuaja.
- * **Ju duhet të mësoni që t’iu përshtateni orareve të ndryshueshme.**
- * **Mund të dalin gjëra urgjente edhe gjatë orëve të vona të natës.**

✱ *Një udhëtim apo një kohë pushimi e planifikuar mund të ndryshojë për shkak të ndonjë rasti vdekjeje në familjen tuaj të kishës.*

Si një partnere në shërbesë, ju duhet të jepni vazhdimisht për të tjerët në mënyra të ndryshme, gjë që mund t'ju shkarkojë frymërisht, e madje edhe fizikisht. Shpeshherë mund të ketë sakrifica në kohën e burrit tuaj. Mbani mend që Krishti duhet të jetë i pari në jetën e tij. Megjithatë, vendosja e Krishtit si primar dhe vendosja e shërbesës si primare, nuk janë e njëjta gjë. Kjo gjë do të kërkojë përshtatje gjatë sezoneve të ndryshme të shërbesës dhe duhet të sillet në lutje vazhdimisht për të dy partnerët.

ZHVILLIMI FRYMËROR DHE PËRKUSHTIMI NDAJ PERËNDISË, PRIORITETI YNË NUMËR NJË



Bashkëshorti im nuk mund ta "njohë" Perëndinë në vendin tim. Një marrëdhënie personale me Jezusin është baza e jetës frymërore. Me anë të Fjalës së Perëndisë, na zbulohen Ati ynë Qiellor, Biri i Vetëmlindur dhe Fryma e Shenjtë.

Lutja është lidhja jetësore me Krijuesin tonë. Është plani i mrekullueshëm për një komunikim frymëror që Perëndia ka siguruar për secilin prej bijve të Tij.

Nëse Jezusi e ndjeu të nevojshme që të lutej ndërsa ishte këtu mbi tokë—që të kalonte kohë me Perëndinë në mënyrë që të bënte sa më plotësisht vullnetin e Atit të Tij—sa më tepër të nevojshme e kemi ne që të kalojmë kohë në praninë e Tij. Ndërsa dallojmë Shenjtërinë e Perëndisë dhe dobësinë tonë, mundemi të dorëzohemi ndaj planit që Ai ka përgatitur për ne. Ndërsa unë kaloj kohë në praninë e Tij, kohë për të dëgjuar zërin e Tij, marrëdhënia ime me Të rritet. Me anë të marrëdhënies sime me Të, unë filloj ta shoh veten time me sytë e Tij. Me dashuri, Ai më formon dhe gdhend për t'u bërë personi që Ai dëshiron që të jem, më shumë i ngjashëm me Të. Ndërsa përshtatem më shumë sipas imazhit të Tij, natyra e Tij fillon të duket gjithmonë e më shumë në jetën time. Pastaj, kur të vij në kohët e vështira, ose kur bëhet e nevojshme të takohem me ndonjë person të padurueshëm, jam më e pajisur për t'i përballuar këto situata. Nuk do të jem duke funksionuar në forcën dhe fuqinë time, por në forcën dhe fuqinë e Krishtit të gjithëpushtetshëm që jeton në mua. Atëherë mund të ndikoj dhe prek të tjerët për Të. Është efekti i natyrshëm i një marrëdhënieje të

përkushtuar me Krishtin.

Gjërat e rëndësishme në jetë nuk duhet të lejohen që të më vjedhin privilegjin e të qenurit në praninë e Atit tim të dashur. Është një zgjedhje e disiplinuar të caktosh një kohë të veçantë për Të. Shpërblimet do të jenë të mëdha. Perëndia do të bekojë bindjen tonë ndërsa i dorëzohemi Atij. Ne do të kemi paqe në zemrat tona dhe gëzim në shpirtin tonë. E vërteta e thjeshtë është që, sa më shumë kohë kalojmë në praninë e Perëndisë, aq më mirë e njohim Atë, aq më e madhe bëhet dashuria jonë për Të, dhe aq më shumë i besojmë Atij. Po, ne të gjithë jemi njerëz, por betejat e jetës fitohen në gjunjë.

Shumë cilësi janë shumë të vlefshme për një bashkëshorte shërbyesi, por ajo me rëndësinë më të lartë është besimi i saj në Perëndinë. Ne duhet të kemi një besim që nuk do të lëkundet kur të mbërrijnë rrethanat e vështira. Është një besim që e di se: *"Ai është shpërblyesi i atyre që e kërkojnë Atë"* (Hebrenjve 11:6). Besimi ynë duhet të shpallë si tre djemtë hebrenj: *"Perëndia ynë është në gjendje të na çlirojë, por edhe sikur të mos e bënte..."* (Danieli 3:16, 17). Kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë kohë shumë prekëse, lëndime të thella e madje zhgënjime. Sidoqoftë, me këtë nënkuptohet se stresi i përditshëm dhe sfidat emocionale nuk do ta kontrollojnë jetën time. Perëndia është në kontroll në çdo rrethanë të jetës. Ai është një Perëndi sovran. Unë zgjedh që t'i besoj Atij si Perëndia që është gjithmonë besnik.

Të pasurit e një besimi të palëkundur është diçka shumë e rëndësishme përgjatë jetës dhe shërbesës për shkak se besimi tek Perëndia ndikon gjithçka që unë bëj dhe i flet fort të gjithë atyre që më rrethojnë. Në mënyrë që të jeni një udhëheqës frymëror efektiv, duhet të jeni të mbushur me Frymën e Perëndisë. Shpesh është thënë: *"Nuk mund të influencosh askënd në një vend më të lartë në Krishtin, sesa niveli yt frymëror"*.

Perëndia ju ka zgjedhur që t'i shërbeni Atij në një vend strategjik udhëheqjeje. Po! Nëse burri juaj është pastor, gjithashtu edhe ju jeni në një vend strategjik udhëheqjeje. Mendojeni këtë për një moment. Për shkak të privilegjit të lartë të të qenit një përfaqësues i Tij, njerëzit vazhdimisht do të jenë duke ju vëzhguar. Ata do të vërejnë sesi e trajtoni burrin tuaj, si i trajtoni fëmijët tuaj, dhe sesi i trajtoni njerëzit e tjerë.

Çfarë nderimi i shenjtë është që të jemi në gjendje që të ndikojmë të tjerët me anë të



veprimeve tona të përditshme. Marrëdhënia jonë me Perëndinë ndikon gjithçka dhe të gjithë të tjerët në jetën tonë.

- * Ndikon mënyrën se si ndjehemi për veten.
- * Ndikon marrëdhënien që keni me burrin tuaj.
- * Ndikon marrëdhënien që keni me bashkësinë.
- * Ndikon njerëzit me të cilët kontakton çdo ditë.

QENIA JOTE UNIKE

Ti je një qenie unike. Ndërsa ti përpiqesh që t'i pëlqesh Zotit me anë të bindjes tënde të nënshtruar, mëson të jesh e kënaqur me atë kush je. Ti nuk je si gruaja e pastorit të mëparshëm apo si gruaja e pastorit të filan kishe tjetër të qytetit. Perëndia i ka dhënë secilës prej nesh aftësi dhe dhunti të ndryshme. Njerëzit do të pëlqejnë disa veçanti tek ti dhe do të pëlqejnë të tjera veçanti tek një grua tjetër pastori. Mbaj mend që ti nuk je në konkurrencë me ndonjë person tjetër në Kishën e Zotit. Ne të gjithë jemi anëtarë të të njëjtit trup (1 Korintasve 12:27). Burri im i mençur gjithmonë thotë: "Kënaqja e vërtetë me atë kush je nuk është matja e vetes me njerëzit e tjerë në një mënyrë krahasuese ose konkurruese." Shumë herë pakënaqësia vjen kur një partnere në shërbesë e krahason veten e saj me dikë tjetër.

Lëndimet frymërore dhe emocionale ndër gratë e shërbyesve shpeshherë vijnë nga konflikte brenda vetes të tyre. Ky konflikt mund të zhvillohet për shkak të perceptimit që ajo ka për:

- * Pritjet e burrit të saj ndaj asaj,
- * Pritjet e bashkësisë ndaj asaj, dhe
- * Pritjet e asaj vetë ndaj vetes, për shkak të një "imazhi" që ajo ka se si duhet të jetë një grua ideale shërbyesi.

Kur unë kam bërë një përkushtim total ndaj Perëndisë, jam e lirë të jem vetvetja, në më të mirën që mund të jem, për lavdinë e Perëndisë. Ndërsa mbushem vazhdimisht me praninë e Perëndisë dhe Fryma e Perëndisë më kontrollon, atëherë mund të relaksohem në Të. Një Atë i dashur do të përdorë personalitetin tim për të përmbushur qëllimin e Tij me anë të jetës sime.

Është shumë e rëndësishme që të jemi të sinqertë në vlerësimin e dhuntive dhe aftësive tona. Kjo më ndihmon shumë në njohjen e vendit që duhet të kem në planin e tij të përgjeshëm. Nuk ka njeri që të arrijë të bëjë gjithçka vetë: dikush mund të ketë dhunti muzikore; një tjetër të jetë i aftë si mësues; ose, si predikues shumë i mirë nga podiumi. Dikush mund të jetë i dhënë pas mikpritjes; e një tjetër akoma mund të jetë një inkurajues. Të gjitha këto janë të rëndësishme në mbretërinë e Perëndisë. Asnjë person nuk del mirë nëse përpiqet të jetë dikush që nuk është. Perëndia e krijoi secilin prej nesh në mënyrë unike sipas imazhit të tij. Por gjithashtu, Ai është duke punuar

vazhdimisht në jetën time për të më bërë gjithnjë e më të ngjashëm me Vetën. Kurrë mos e kufizo atë që Perëndia dëshiron të bëjë në jetën tënde, apo mënyrën se si dëshiron të të përdorë. Ai mund të zbulojë aftësi specifike në ty në rrethana të ndryshme. Para këtyre, mund të mos kesh qenë i ndërgjegjshëm që e kishe atë aftësi për të qenë efektiv në atë fushë të shërbesës. Ndërsa ti e nënshtron veten ndaj Tij dhe punës që Ai të ka thirrur të bësh, ai vazhdimisht do të të zgjerojë dhe do të zhvillojë dhuntitë që ka vendosur brenda teje.

Një sondazh është kryer mes besimtarëve të thjeshtë duke iu kërkuar atyre që të rendisin se çfarë iu duket e rëndësishme tek një grua pastori.

- * Një person me karakter të përkushtuar të krishterë
- * E sinqertë
- * Miqësore
- * Një personalitet i hirshëm
- * Me sens humori
- * Një fytyrë e çelur
- * E kuptueshme
- * Simpatizuese
- * E gatshme të dëgjojë
- * I ruan gjërat e thëna në konfidencë
- * E rregullt
- * Dikush madje tha: "normale në mënyrën e vet të sjelljes"

Këtyre unë do t'iu shtoja me siguri:

- * I do të gjithë njerëzit me sinqeritet
- * Një logjikë e shëndoshë
- * Durim (me të shoqin, fëmijët, anëtarët e kishës, miqtë dhe me veten)
- * E zonja me financat
- * Që nuk mban inate apo lëndime
- * Gjithmonë dallon anët më të mira tek të tjerët
- * Pozitivitet në qëndrime

Këto janë cilësi që duhet të gjenden në çdo besimtar të krishterë, veçanërisht tek ata që janë në pozicione udhëheqjeje frymërore. Te Filipianëve 4:13 thuhet: "Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon."

"Zot, më mbush aq plot me Vetën Tënde sa që nga brendësia ime të derdhen cilësitë e Jezus Krishtit që banon në mua. Gjatë jetës sime të përditshme të tjerët të shohin Krishtin dhe të dëshirojnë ta njohin Atë si Shpenguesin e tyre personal. Cilado të jetë detyra që Ti ke caktuar për mua, të nënshtrohem me gatishmëri dhe përpulësi Ty si Zot i jetës sime."



MARCIA LEDNICKÝ është një folëse në takime, konferenca dhe seminare për gratë. Ajo ka një aftësi unike për të lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat biblike. Shërbesa e saj si folëse pasurohet edhe nga talenti i saj vokal me anë të të cilit ajo komunikon dashurinë e Krishtit.

Të jetuarit sipas **MBRETËRISË**

Në numrin e mëparshëm, u paraqit themeli për kuptimin biblik të të *Jetuarit Sipas Mbretërisë*. Ka vetëm dy mbretëri frymërore — Mbretëria e Dritës dhe Mbretëria e Errësirës. Drita vjen nga i Plotfuqishmi; errësira vjen nga i ligu, Satani.

Por, Perëndia dhe Satani nuk janë kundërshtarë të barabartë. Satani (Luciferi, një engjell i një rangu të lartë) ishte një qenie e krijuar që u rebelua kundër Perëndisë dhe u përpoq që ta lartësonte veten për t'u bërë më i madh se Krijuesi i tij. Kjo betejë vazhdon në këtë tokë edhe sot e kësaj dite. Pra, dhe njeriu duhet të zgjedhë se në cilën mbretëri do të jetojë. Në Krishtin ka Dritë dhe Jetë. Vetëm Ai mund të na çlirojë nga errësira e të na sjellë në dritë. Tani, kemi përpara sfidën për ta njohur Atin tonë Qiellor përmes natyrës së Tij dhe attributeve që Ai ka.

Atributet
^e **ATIT** ^{të}
Përrjeshëm

Nga **Dr. H. MAURICE LEDNICKY**

PJESA II

Është e vështirë të gjesh fjalë për ta përshkruar apo përkufizuar në mënyrën e duhur Perëndinë Atë. Dhe, arsyeja është shumë e thjeshtë. Fjalori ynë i kufizuar nuk ka fjalë për ta përshkruar një Perëndi të pafund. Njohuria e njeriut për të Plotfuqishmin është e kufizuar, dhe veçanërisht që nga koha e rebelimit të Adamit dhe Evës në Kopshtin e Edenit. Satani e shtrembëroi të vërtetën (gënjeu) kur i tha Evës se “Perëndia e di që sytë tuaj do të hapen sapo të hani prej saj, dhe ju do të jeni si Perëndia, do të njihni të mirën dhe të keqen” (Zan. 3:4, NLT). “Krijesa” kurrë nuk evoluon në barazi me “Krijuesin.” Pra, me përpjekjet tona më të mira dhe zemra të përlurura e të ndriçuara nga Fryma e Shenjtë, me përkushtim ne kërkojmë në Fjalën e Perëndisë për kuptim i cili do të zbulojë karakterin dhe natyrën e Tij të përjetshme. Duke bërë këtë, Ai bëhet akoma më i lavdishëm dhe madhështor në të kuptuarit tonë—Perëndia nuk mund të jetë më i madh se ç’ka qenë gjithmonë nga përjetësia. Kur Davidi këndoi: “O lartojeni Zotin bashkë me mua dhe të lëvdojnë të gjithë emrin e Tij” (Psalmi 34:3), ose kur Maria tha: “Shpirti im madhëron Perëndinë...” (Luka 1:46), ata po shpallnin që Perëndia ishte madhëruar për ta për shkak se kishte manifestuar veten e Tij.

PËR SA I PËRKET PËRJETËSISË

Në horizontin e njohjes njerëzore, përjetësia thjesht nënkupton mospasjen e kufijve apo kufizimeve të “njohura”. Ndërsa qiejt vijnë të vrojtohen me teleskopë gjithmonë e më të fuqishëm, njeriu vazhdon të zbulojë gjithmonë e më shumë galaktika—shumë prej tyre akoma më të mëdha se ajo në të cilën ne jetojmë. Tani ka prova shkencore për ekzistencën e një milion a më shumë galaktikave të tilla. Prandaj, shumë shpejt dilet në përfundimin që numri i madh i galaktikave nuk ka kufi. Megjithatë, unikaliteti i Perëndisë është që nuk ka kufizim apo kufij ekzistenca e Tij. *Perëndia nuk është shuma e gjithçkaje që ekziston; përkundrazi Ai tejkalon gjithçka që ekziston.* Për shembull, Perëndia nuk është në natyrë, sepse Ai është Krijuesi i gjithçkaje, dhe si i tillë, është më i lartë se krijesa e vet. Kjo vetëm sa e përforcon të vërtetën biblike që Perëndia nuk mund të kuptohet plotësisht nga inteligjenca e kufizuar e njeriut të rënë.

“Mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja,” thotë Zoti. ‘Dhe as rrugët e mia nuk janë rrugët tuaja. Ashtu si qiejt janë më të lartë se toka, kështu edhe rrugët e mia janë më të larta se rrugët tuaja dhe mendimet e mia janë më të larta se mendimet tuaja.’” (Is.55:8, 9, NLT).

“O thellësi pasurie, urtësie dhe diturie të Perëndisë! Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e tij dhe të pashtershme janë udhët e tij!” (Rm.11:33).

1. Vetë-ekzistenca

Në zbulesën progresive të Vetes së Tij ndaj Izraelit, Zoti i deklaroi Moisiut: “*UNË JAM AI QË JAM*” (Eks. 3:14). Për më tepër, në konfirmimin e premtimeve të Besëlidhjes së Tij ndaj Moisiut kur Faraoni nuk po reagonte ndaj kërkesës së Moisiut për t’i lejuar izraelitët të largoheshin nga Egjipti, Zoti thotë: “*Unë jam Zoti; dhe i jam shfaqur Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, si Perëndi i Plotfuqishëm (El Shaddai—i Plotfuqishmi), por ata nuk më kishin njohur kurrë me emrin tim, Zot (JEHOVAH)*” (Eks.6:2,3 KJV) (shtesat janë vendosur nga autori i artikullit). Jezusi shpalli: “*para se Abrahami të kishte lindur, UNË JAM*” (Gjoni 8:58).

Perëndia është absolutisht i plotë në vetvete. Është vetë natyra e Perëndisë “të jetë.” Kjo është tepër e rëndësishme për studimin tonë të mbretërisë frymërore. Nëse ka ndonjë perëndi tjetër që ka ekzistuar përpara Perëndisë së Vërtetë, ose, nëse ka ndonjë perëndi tjetër që mund të deklarohet si një i barabartë me të, atëherë i gjithë autoriteti i sistemit tonë të besimit shkatërrohet. Ai nuk ka fillim e as fund. Ai gjithmonë ka qenë—Ai gjithmonë do të jetë. Lavdi Perëndisë tonë!

2. I Pandryshueshëm

Një përkufizim i thjeshtë i termit “i pandryshueshëm” do të ishte që nuk ndryshon, me forcën e shtuar e të qenit krejtësisht i aftë për të ndryshuar. Ne mund t’ia veshim këtë cilësi disa qenieve njerëzore që janë të fiksuara fort mbas opinioneve të tyre; por, në realitet kjo mund të përshkruajë të Plotfuqishmin.

Në volumnin e tij mbi Teologjinë Sistematike, A. H. Strong arrin në këtë përfundim për sa i përket pandryshueshmërisë së Perëndisë: “*Me këtë ne nënkuptojmë që natyra, atributet dhe vullneti i Perëndisë janë të përjashtuara nga çdo ndryshim. Arsyeja na mëson që asnjë ndryshim nuk është i mundur tek Perëndia, qoftë shtues apo zvogëlues, përparues apo keqësues, kontraktues apo zhvillues. I gjithë ndryshimi duhet të ketë të bëjë me përmirësim apo keqësim. Por Perëndia është përsosmëri absolute dhe asnjë ndryshim përmirësues nuk është i mundur. Ndryshimi keqësues do të ishte po aq i papërpunueshëm me përsosmërinë. Asnjë shkak për ndryshim nuk ekziston, as jashtë Perëndisë, as në vetë Perëndinë.*”

Disa persona mund të argumentojnë se ka prova që Perëndia ndryshoi mendje, si në rastin e Ninives kur populli u pendua (Jona 3:10). Por, karakteri i Perëndisë nuk ndryshoi në asnjë mënyrë, sepse drejtësia dhe mëshira i ofrohen njëloj të gjithë njerëzve. Prandaj, në të vërtetë, ishte njeriu që ndryshoi (u pendua) dhe kështu gëzoi mëshirën e

Perëndisë. Shpeshherë ka “kushte” që shoqërojnë premtimet e Perëndisë. Nëse ti je i gatshëm, edhe Perëndia është.

Profeti i fundit i Dhiatës së Vjetër, Malakia, shkroi fjalët e vetë Perëndisë: “Unë jam Zoti, nuk ndryshoj...” (Malakia 3:6). Shkruesi i Letrës Drejtuar Hebrenjve shpall që “Jezus Krishti është i njëjti dje, sot, e përgjithmonë” (Heb.13:8, NLT). Gjoni i Zbulësës frymëzohet të përdorë germën e parë dhe të fundit të alfabetit të greqishtes—Alfa dhe Omega—katër (4) herë tek Zbulesa. Dëgjojeni shpalljen e ngazëllueshme: “‘Unë jam Alfa dhe Omega—fillimi dhe mbarimi,’ thotë Zoti. ‘Ai që është dhe që ishte dhe që vjen—i Plotfuqishmi’” (Zbu.1:8, NLT).

3. Një i Vetëm

Fjala e Perëndisë është plotësisht e qartë që ka vetëm NJË Perëndi të vërtetë.

“Dëgjo, O Izrael, Zoti Perëndia ynë është një Zot [i vetmi Zot]” (Ligji i Përtërirë 6:4, Amp.).

“Kështu thotë Zoti—Mbreti i Izraelit dhe Çliruesi i Tij, Zoti i Ushtirive: ‘Unë jam i pari dhe jam i fundit dhe përveç meje nuk ka Perëndi’” (Isaia 44:6, NLT).

“Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezus Krishtin që Ti ke dërguar” (Gjoni 17:3, NLT).

“Mbretit të amshuar, të pavdekshmit, të padukshmit, të vetmit Perëndi të ditur, i qoftë nder e lavdi në shekuj të shekujve. Amen” (1 Tímoteut 1:17, ESV).

Fakti që Perëndia është një nuk është aspak në kontradiktë me doktrinën e **TRINISË** (vetë fjala nuk gjendet tek Shkrimet), që zbulohet në mënyrë shumë të qartë në Dhiatën e Re, ndërsa Biri dhe Fryma e Shenjtë erdhën mbi këtë tokë për detyra të veçanta, specifike. Krishti erdhi që të paguajë dënimin për mëkatën e njeriut; Fryma e Shenjtë u dha që të tërheqë njerëzit tek Krishti dhe të banojë brenda besimtarëve. Kjo e vërtetë shquan dallime personale në natyrën hyjnore, por edhe pranon që natyra hyjnore është përbërëse e një.

Çdo kufizim ndaj kësaj qenieje përsosmërisht në unitet është vetë-vendosur për qëllimet e Perëndisë. Për shembull, Krishti e la qiellin dhe mori mbi vete trajtën e një njeriu. Me fjalë të tjera, ai e kufizoi veten në një trup njerëzor për një kohë të shkurtër (afërsisht tridhjetë e tre vjet) kur Ai ishte këtu mbi tokë (Filipianëve 2:5-11).

LIDHUR ME GJITHË KRIJESËN

Atributet e Perëndisë që fillojnë me fjalën “gjithë” (omni) tregojnë në mënyrë të thjeshtë e megjithatë të saktë dhe të thellë që Perëndia i Përbërës është **I GJITHËPRANISHËM, I GJITHËDITUR** (ka të gjitha njohuritë dhe zotëron gjithë mençuritë) dhe **I GJITHËFUQISHËM**. Ndërsa mahnitja jonë me

Perëndinë sa vjen e rritet, mbetet që ne duhet të jemi jashtëzakonisht të kujdesshëm që të mos i veshim Atij kuptime të paqena që Shkrimet e Shenjta nuk ia japin. Për shembull, në përpjekje për të mbështetur faktin se Ai është i gjithëpranishëm, të shpallësh që Ai është “në” pemët e pyllit—ndaj dhe pemët duhen adhuruar—do të thotë ta ulësh Perëndinë në një pikëpamje panteiste (që domethënë se të gjitha manifestimet materiale të Perëndisë duhen adhuruar) të natyrës. Si Krijues i të gjitha gjërave, Perëndia nuk është “në” natyrë ose “i barabartë” me natyrën; Ai tejkalon (është më i madh se) gjithçka që Ai ka krijuar. Ose, ka një tendencë për të krahasuar “njohurinë dhe urtësinë” e Perëndisë përkundrejt “fuqisë” së Perëndisë. Njëra cilësi nuk është më e madhe se tjetra. Ato janë njëlloj attribute të Perëndisë. Urtësia e Tij sovranë nuk i bën hije fuqisë së Tij sovranë, e as anasjelltas.

1. Gjithëprania

Shkrimet, veçanërisht Psalmet, e përshkruajnë Perëndinë si të ngritur dhe të lartësuar mbi gjithë tokën. “Kush i përngjan Zotit, Perëndisë tonë, që banon në vende shumë të larta? Kush ulet për të parë gjërat që ndodhen në qiejt e mbi tokë?” (Ps.113:5, 6, NLT). Një gjuhë e tillë poetike nuk flet për një Perëndi të shkëputur, jopersonal që është aq larg njerëzve sa që nuk ka fare lidhje me ta. Përkundrazi, kjo është një shprehje nderimi për madhësinë e Madhërisë së Tij. E njëjta gjë është e vërtetë për sa i përket lutjes së Solomonit në përkushtimin e tempullit që sapo ishte përfunduar. “O Zot, Perëndia i Izraelit, nuk ka asnjë perëndi të ngjashëm me ty as atje lart në qiell, as këtu poshtë në tokë... Por a është e vërtetë që Perëndia banon mbi tokë? Ja, qiejt dhe qiejt e qiejve nuk mund të të nxënë dhe aq më pak ky tempull që kam ndërtuar!” (1 Mbret.8:23, 27, NLT).

Psalmi i mrekullueshëm i Davidit, Psalmi 139, ofron një përshkrim të fuqishëm të gjithëpranisë dhe gjithëdijes së Perëndisë. Për këtë moment, shikoni si janë thurur me frymëzim vargjet 7-10: “Ku mund të shkoja larg Frymës tënde? Ose ku mund të ikja larg pranisë sate? Në rast se ngjitem në qiell, ti je atje; në rast se shtrij shtratin tim në Sheol, ti je edhe aty. Në rast se marr krahët e agimit dhe shkoj të banoj në skajin e detit, edhe aty dora jote do të më arrijë” (NIV).

E vërteta e zbatueshme është që Perëndia është me bijtë e Tij gjithmonë—kudo që të ndodhemi dhe në çfarëdo rrethane. “Sepse sytë e Zotit shikojnë përpara dhe mbrapa në tërë dheun për të treguar forcën e Tij ndaj atyre që kanë një zemër të ndershme ndaj Tij” (2 Kron.16:9, ESV).

2. Gjithëdija

Është kombinimi i pakrahasueshëm i **NJOHURISË** dhe i **MENÇURISË** që krijon siguri dhe besim në ata që e njohin Perëndinë. Me fjalë të thjeshta, njohuria është përvetësim i fakteve; mençuria është zbatimi i

duhur i atij informacioni. Sidoqoftë, njohuria e Sovranit nuk arrihet me anë të procesit të arsytimit tonë të kufizuar. Kjo është e vështirë—në fakt, e pamundur—për t'u kuptuar nga ne, përderisa njohuria njerëzore arrihet me anë të shqisave. Edhe atëherë, njohuria e njeriut është në ndërtim e sipër, gjithmonë duke ndryshuar, me mbledhjen e “fakteve” të reja. Njeriu fillon me provat empirike të mbledhura me anë të përvojës historike dhe kërkon që të kacavirret më lart për të përkufizuar mençurinë e Perëndisë së përjetshëm. Njeriu nuk do të arrijë kurrë njohurinë apo mençurinë e pafundme; dhe, kështu, përpjekjet e tij për ta bërë këtë janë krejtësisht të kota.

Po bëj një pauzë për një moment për t'iu adresuar një pyetjeje që pothuaj gjithmonë vjen në qendër të vëmendjes kur diskutohet njohuria gjithëpërfshirëse e Perëndisë. “Nëse Perëndia njih çdo gjë, atëherë Ai është përgjegjës edhe për mëkatin origjinal?” Përgjigjja është një JO e fortë! Perëndia vërtet ka njohuri të plotë paraprake. Ai e dinte që Luciferi (Satani) do të rebelohej. Ai e dinte që Adami dhe Eva do të binin në mosbindje në Kopshtin e Edenit. Por, përderisa krijesës së Tij iu lejua fuqia e zgjedhjes, Ai nuk i detyroi ata që të kryejnë këto akte mëkati. Siç do ta diskutojmë më vonë, Perëndia nuk krijoi skllëvër, të detyruar që të bëjnë çfarë u komandohet. Në gjerësinë e dashurisë së Tij, Ai krijoi qenie që do të zgjedhin vullnetarisht ta adhurojnë dhe t'i shërbejnë. Kaq e plotë ishte paranoja hyjnore sa që plani për shpengimin e njeriut u vu në lëvizje madje para se bota të zinte fill.

“Por [ju jeni blerë] me gjakun e çmuar të Krishtit (Mesias), si ai i një qengji [të flijuar] pa të meta e pa njollë. Është e vërtetë që Ai u zgjodh dhe u paracaftua (i destinuar dhe i paranojohur për këtë) që para themelimit të botës. (1 Pjetrit 1:19, 20, Amp.) (theksi nga autori).”

Jam i mahnitur nga shprehja e Solomonit: “Me diturinë Zoti krijoi tokën; dhe me zgjuarësinë i bëri të qëndrueshëm qiejtë” (F.Urta. 3:19, KJV). Pse nuk tha ai, “me anë të fuqisë së Tij”? Në leximin e tregimit të Zanafillës mbi Krijimin, është mjaft e qartë se Perëndia thjesht “foli” dhe kjo tokë dhe ekosistemi i saj i ndërlukuar erdhën në ekzistencë. Pra, nuk ka dyshim për fuqinë e Tij. E megjithatë, gjithë krijimi nuk qe një shfaqje e shfrenuar force. Çdo detaj u shqyrtua mrekullisht—që nga peshqit që jetojnë në ujë e deri te pemët që mbajnë frutat e ngrënshme. A e keni menduar ndonjëherë sa i mrekullueshëm është trupi njerëzor me zemrën që pompon gjakun nëpër mijëra venat dhe kapilarët pa pushuar ndonjëherë që nga lindja e deri në vdekje?

Në përpjekje për ta përqafuar këtë gjithëdije në një nivel personal, shpesh ne kemi beteja besimi dhe sigurie në Zotin. Në logjikën tonë dhe sistemin e “drejtësisë” dhe të “së drejtës,” ne nuk gjejmë përgjigje të përshtatshme për disa ngjarje që ndodhin. “Pse

ndodhi kjo?” është një pyetje e shpeshtë që sulmon mendjet e njerëzve, madje dhe të besimtarëve. Shembulli ynë i përsosur, Zoti Jezus Krisht, siguron modelin për ne. Nga pagëzimi i Tij prej Gjonit në Lumin Jordan (Mat.3:13-17), “njeriu” Jezus kuptoi misionin e tij tokësor. Në ato momente të hershme me vetëdije të plotë se përpara e priste vdekja e sigurt, Satani vjen ta tundojë rëndë (Mat.4:1-11), madje duke i ofruar Jezusit një “rrugë më të lehtë” për të fituar botën, vetëm nëse ai përulej dhe e adhuronte atë (Mat.4:8-10). Pa diskutim, beteja më e fortë e Shpëtimtarit tonë erdhi vetëm pak orë para se Ai të shkonte në kryq. Në kopshtin e Gjetsemanisë, Jezusi u lut fort tri (3) herë: “Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë (të vuajtjes, vdekjes); **megjithatë, jo si dua unë, por si do Ti**” (Mat.26:38,39, ESV) (shitesat dhe theksimet janë vendosur nga autori i artikullit). Në fund të fundit është çështje mirëbesimi të plotë në Perëndinë rrugët e të cilat janë gjithmonë të drejta dhe më të mirat (Ps. 18:30). Dëgjoni dhe një herë fjalët siguruese të shkruara nga pena e Apostullit Pal besimtarëve në Romë:

“Dhe ne e dimë se të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë thirrur sipas qëllimit të Tij. Sepse ata që ai ka njohur që më parë, edhe i ka paracaftuar që (1) të jenë të ngjashëm me shëmbëlltoren e Birit të Tij, kështu që ai të jetë i parëlinduri në mes të shumë vëllezërve. Dhe ata që ai i paracaftoi, (2) edhe i thirri të vijnë te Ai. Dhe ata që i thirri, (3) edhe i shfajësoi duke i drejtësuar në veten e Tij. Dhe mbasi i drejtësoi, (4) ata edhe i përlëvdoi” (Rom.8:28-30, NLT) (shitesat dhe nënvizimet nga autori).

3. Gjithëfuqia

A ka studim më ngazëllues në Fjalën e Perëndisë sesa tregimet e shumta që regjistrojnë fuqinë e tij madhështore?

- Krijimi i “qiejve dhe tokës” (Zan. 1)
- Moisiu që udhëhoqi Bijtë e Izraelit në kalimin e Detit të Kuq (Zan. 14)
- Muret e Jerikos “u rrëzuan” (Joz. 6)
- Ushtria e Gideonit prej 300 burrash që mundën Madianitët (Gjy.6-7)
- Elija që zbret zjarr nga qielli për të konsumuar sakrificën (1 Mbret. 18)
- Danieli të cilin e hedhin në gropën e luanëve (Dan.6)
- Mrekullitë e shumta që bëri Jezusi (shërime fizike, çlirimet nga demonët, fuqia mbi natyrën) (Mateu, Marku, Luka, Gjoni)
- Shërimi i të çalit në portën e Tempullit (Vep. 3)
- Pjetri që lirohet nga burgu në Jerusalem (Vep.12)
- Ringjallja e Krishtit nga të vdekurit! (Mateu 28, Marku 16, Luka 24, Gjoni 20)

E njëjta fuqi që i Plotfuqishmi shpërfaqti përgjatë

mijëvjeçarëve të kaluar nuk është ndryshuar apo pakësuar. Besimtarët e mbushur me Frymën sot janë fuqizuar që të përjetojnë të njëjtat shpërfaqje të fuqisë së Perëndisë. Porosia e Madhe përfshin edhe shenja e mrekulli, që do të vërtetojnë ungjillin (Marku 16:15-18). Kuptohet që, ne shpesh lutemi për fuqinë e Perëndisë që të shfaqet në/përmes jetëve tona. Dhe, Perëndia sigurisht që është i gatshëm që të tregojë lavdinë e Tij në këtë brez, ashtu siç e ka treguar në kohët e shkuara.

Megjithatë një fjalë paralajmëruese është që të mos përpiqemi të përdorim fuqinë e Perëndisë për lavdi personale. Nxitja jonë duhet të jetë përlëvdimi i Perëndisë. Fjalët e Jezusit janë si inkurajuese, ashtu dhe udhëzuese. “Në të vërtetë po ju them: kush beson në mua do të bëjë edhe ai **veprat që bëj unë, madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, sepse unë po shkoj tek Ati. Dhe çfarëdo të kërkonti në emrin tim, do ta bëj, që Biri të përlëvdojë Atin. Po, në qoftë se do të kërkonti diçka në emrin tim, unë do ta bëj!”** (Gjoni 14:12-14, NLT) (nënvizimet janë vendosur nga autori i artikullit).

Apostulli Gjon shtjellon më tej në lidhje me atë që ka regjistruar në Ungjill, në letrën e tij të parë. “Dhe kjo është siguria që kemi përpara Tij: nëse **kërkojmë diçka sipas vullnetit të Tij, ai na e plotëson. Dhe nëse e dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne e dimë që i kemi ato që i kërkuam Atij**” (1 Gjoni 5:14,15, KJV) (nënvizimet nga autori i artikullit).

LIDHJA PERSONALE ME KRIJESËN MORALE

Në këtë mënyrë, njeriu e njeh Perëndinë në një mënyrë personale. Fjala e përdorur rëndom është *marrëdhënie*. Sidoqoftë, duhet të mbahet mend që kjo marrëdhënie me njeriun është me iniciativën e Tij. Që nga krijimi i Adamit dhe i Evës deri në shpengimin final të atyre që e pranojnë faljen e Tij me anë të Krishtit, ky është plani i Perëndisë. Njeriu nuk sjell dot asgjë në tryezë. Nuk ka negociata, diskutime, asnjë

vepër nuk mund ta fitojë shpëtimin. Megjithatë, me gjithë mendimet dhe veprat tona mëkatore që vijnë nga natyra jonë e shthurur, Perëndia dëshiron të ketë një marrëdhënie personale me ne—krijesën e tij morale. Vënë në këtë kontekst, madhështia e bujarisë së shenjtë dhe hiri i mëshirshëm janë vërtet mahnitëse.

Nuk jam duke u përpjekur këtu që të vendos në një radhitje sipas rëndësisë të tri atributet e Perëndisë që janë përmendur. Disa studiues kanë përcaktuar që *Shenjtëria* është atributi më i lartë (kryesor). Nëse e kuptoj saktë, secili atribut i Perëndisë është përsosmëri absolute. Prandaj edhe njëri nuk mund të jetë më i lartë se tjetri—pasi pastaj njëri do të ishte më i përsosur se të tjerët. Një përfundim i thjeshtë: **I GJITHË PERËNDIA është I GJITHI PERËNDI.** Nuk ka asnjë ndasi apo konkurrencë brenda vetes së Tij.

1. Dashuria

Bibla qartësisht shpall: “Perëndia është dashuri” (1 Gjoni 4:8). Ky është një dimension i padiskutueshëm, i brendshëm, i pandryshueshëm i natyrës së Tij. Këtu pra, ne jemi duke folur për dashurinë e Perëndisë shprehur ndaj krijesës së Tij morale. Meqenëse dashuria është diçka subjektive dhe jo objektive, tendenca është që të përkufizohet dashuria e Perëndisë sipas perceptimit tonë personal. Shpesh predikuesit e deklarojnë dashurinë e Perëndisë si dashuri “pa kushte.” Një shpallje e tillë është sa e vërtetë, aq edhe e rreme. Nëse nënkupton që Perëndia na do edhe kur nuk e meritojmë, atëherë është e vërtetë (Rom.5:8). Nga ana tjetër, nëse nënkupton që Perëndia kurrë nuk na kërkon llogari për veprimet tona, atëherë nuk është e vërtetë (Rom. 14:12). Pra, ne duhet të përqafojmë me kujdes të gjithë mësimin e Shkrimeve për sa i përket dashurisë së Perëndisë.

Si ndjekës të Krishtit, ne e kuptojmë madhështinë e dashurisë së Perëndisë ndaj njeriut të rënë dhe mëkatar. “Por Perëndia që është i pasur në mëshirë, për shkak të dashurisë së Tij të madhe me të cilën na deshi, edhe atëherë kur ishim të vdekur në fajë, na dha jetë në Krishtin—ju në fakt jeni të shpëtuar me anë të hirit...dhe kjo nuk vjen nga ju, por është dhurata e Perëndisë...” (Ef.2:4-8, ESV). Është po aq e rëndësi-shme që ne të dimë dhe përjetojmë disiplinën (trajnimin) e dashurisë së Perëndisë në jetët tona. “Biri im mos e përçmo qortimin (disiplinën) e Perëndisë, dhe mos e humb zemrën kur Ai të qorton (ndëshkon për gabimet). Sepse Perëndia ndreq ata që do dhe fshikullon çdo bir që i pëlqen.’ Në qoftë se ju do ta duroni qortimin, Perëndia do t’ju trajtojë si bij... Ai na ndreq për të mirën tonë që të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së Tij” (Heb.12:5-11, NLT).

Mbani mend, “ASGJË në të gjithë krijesën e tij nuk mund t’ju ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jezus Krishtin, Zotin tonë” (Romakëve 8:37-39, ESV).



Njëra dorë mbahet në **GJITHËFUQINË** e Perëndisë me siguri të plotë besimi që Ai ka **FUQINË** që të bëjë gjithçka. Dora tjetër mbahet pas **GJITHËDIJES** së Perëndisë me siguri të plotë besimi që Ai ka edhe **MENÇURINË** për të bërë çdo gjë siç duhet.

2. Shenjtëria

"I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë" është dëshmia e pareshtur e serafinëve (engjëjve të rangut të lartë) që fluturojnë mbi Fronin e Perëndisë, duke i dhënë Perëndisë nderimin që meriton dhe duke deklaruar pastërtinë e panjollë të Perëndisë (Isaia 6:2,3). Në marrëdhënien e Tij me njeriun, Perëndia gjithmonë përshkruhet si i shenjtë.

- Në librin e Eksodit kur Perëndia po i jep udhëzime Moisiut për tabernakullin dhe modelin (sakrificat, kremtimet, dhe ofertat) e adhurimit për izraelitët (tashmë jashtë Egjiptit), deklarohet se është i shenjtë. Që nga fillimi, Perëndia duhet të nderohej për natyrën e tij të shenjtë, që nuk mund të kopjohet nga njeriu i rënë.
- Në librin e Levitikut kur Perëndia po themelonte udhëzimet për krijesën e tij morale, tema e gjithë këtyre marrëdhënieve ishte pastërtia. Respekti i duhur për njëri-tjetrin—e madje dhe për pronat—duhet të ishte standardi normal i sjelljes. Kishte paralajmërime solemne dhe ndëshkime të rënda për ata që refuzonin të bindeshin ndaj urdhërimeve të Perëndisë.
- Ndërkohë që i vetmi plan për të hyrë në praninë e Perëndisë së shenjtë u bë i qartë në Birin e Tij, Jezus Krishtin, nuk pati lehtësim në kërkesat për të jetuar një jetë të shenjtë. Në fakt, Dhiata e Re përforcon thirrjen për të jetuar një jetë të shenjtë. Ajo çfarë shqiptohej në formë të shkruar për sa i përket veprimeve në Ligjin e Moisiut, tani është ngritur nga Zoti ynë në një nivel më të lartë për të përfshirë edhe mendimet, motivimet, dhe qëndrimet. Në Predikimin në Mal (Mateu 5-7), Jezusi përdor frazën: *"keni dëgjuar të thuhet... por unë po ju them"* për të bërë thirrje për një marrëdhënie të shenjtë me një Perëndi të shenjtë, duke themeluar një model për një shenjtëri të brendshme.
- Apostulli Pjetër thekson që "drejtësia e jashtme" duhet të jetë produkt i "shenjtërisë së brendshme" (1 e Pjetrit 1:13-17). Është e mundur për një person që të jetojë një stil jetese të drejtë nga jashtë—shikoni udhëheqësit fetarë që Jezusi kaq shpesh i qorton (Mateu 23) për "standardin e tyre të dyfishtë"—e megjithatë të mos jesh i pastër në njeriun e brendshëm. Ti mund të jesh "i drejtë" pa qenë "i shenjtë", por nuk mund të jesh "i shenjtë", pa qenë "i drejtë".



Dr. H. MAURICE LEDNICKÝ,

shërbyes i shuguruar me Asambletë e Perëndisë për 50 vjet. Ai është autor, ungjilltar, pastor, misionar, dhe ish-president i shkollës Central Bible College, Springfield, Missouri.

3. E vërteta

Të thuash që Perëndia është i vërtetë mund të çojë në keqkuptime të rënda. Kjo vjen për shkak se ne shpesh e barazojmë të vërtetën me atë që perceptohet saktë nga shqisat tona ose që mund të verifikohet nga një studim i kujdesshëm i shkencës. Por Perëndia është më shumë sesa e vërteta e zbuluar. Ai është Burimi i të gjithë të vërtetës. E vërteta nuk është asnjëherë arbitrare—si të ishte zgjedhje thjesht merre ose lëre. Perëndia e njeh dhe e dëshiron të vërtetën, sepse Ai është e Vërteta. Prandaj, Atij mund t'i besohet lirisht dhe plotësisht në gjithçka që Ai thotë për veten. Në lutjen e Jezusit për dishepujt e Tij (dhe për kishën) pak para se të shkonte në kryq, ai tha: *"Shenjtëroji ata [pastroji, ndaji veçmas për veten Tënde, bëji të shenjtë] në të Vërtetën tënde; Fjala Jote është e Vërteta"* (Gjoni 17:17, Amp.).

Përgjatë gjithë shkrimeve të Palit, ai thekson që Perëndia nuk gënjen (Romakëve 3:4; 2 Timoteut 2:13; Titit 1:2). E thënë thjesht, Perëndia nuk mund të mohojë natyrën e Vet, që është përsosmëri absolute dhe, si pasojë, e vërteta absolute.

Dikush me të drejtë mund të pyesë, si e ndikon e gjithë kjo jetën time? Përsëri kthehemi tek themeli i Mbretërisë së përjetshme. Nëse fjalët e folura nga Perëndia dhe demonstruar nga vetë krijesa e Tij morale nuk janë të vërteta, atëherë çfarë të besojmë ne? A mund të bëhemi kaq njerëzisht racionalë në të menduarit tonë sa që të gjeturit e Perëndisë me anë të besimit të mos merret parasysh? A është e mundur që Satani të përdorë edhe intelektin për të depozituar fara dyshimi mbi realitetin e Perëndisë si e Vërteta e pafundme?

E Vërteta e zbuluar është Fjala e Perëndisë. Psalmi 119 — kapitulli më i gjatë në Bibël — flet për urdhërimet, statutet, ligjet, porositë, rregullat dhe udhëzimet e dhëna nga Perëndia. Për Davidin, kjo Fjalë ishte *"një llambë që më udhëheq në rrugë dhe një dritë në shtegun tim"* (Psalmi 119:105). Jezusi ishte "Fjala e gjallë" dhe sot ne shohim tek "Fjala e shkruar" që na zbulon "Fjalën e gjallë" për ne dhe për udhëzim të përditshëm dhe mësim në ecjen tonë të besimit.

Në numrin e ardhshëm, diskutimi ynë do të përqendrohet në faktin se ne jemi të përtërirë në marrëdhënien me këtë Perëndi të Plotfuqishëm. Plani i mahnitshëm i Perëndisë për njeriun e rënë që të përtërihet dhe të hyjë në këtë marrëdhënie me Të është ngazëllues për çdo fëmijë të Perëndisë. Në mënyrë që të kuptojmë plotësisht këtë të vërtetë të fuqishme, është e nevojshme që ne të shqyrtojmë qëllimin origjinal të Perëndisë përse e krijoi njeriun. Një Perëndi përsosmërisht i shenjtë pranon njeriun e rënë në prezencën e Tij me anë të sakrificës së vullnetshme të Birit të tij, Jezusit.

Falenderim në Gilgal

Teksti: Jozueu 5:1-15

HYRJE

Mbasi populli i Izraelit kaloi lumin Jordan, ata vendosën një përmendore gurësh në bregun e Gilgalit atje ku Zoti i kishte futur në Tokën e Premtuar. Ata vendosën edhe një tjetër përmendore në mes të Jordanit.

Në Gilgal, popullit iu bë thirrje që të kujtonte se çfarë kishin qenë dhe çfarë ishin bërë në Perëndinë. Falenderimi ishte një pjesë e të kujtuarit.

MESAZHI

- 1. Ata kujtuan shpengimin e Perëndisë**
 - a. Nga skllavëria egjiptiane.
 - b. Përmes Detit të Kuq.
- 2. Ata kujtuan udhëheqjen e Perëndisë.**
 - a. Me anë të Moisiut.
 - b. Me anë të pllakave të Ligjit.
 - c. Me anë të resë gjatë ditës dhe kolonës së zjarrit gjatë natës.
 - d. Tani me anë të Jozueut.
- 3. Ata kujtuan besëlidhjen e Perëndisë që u bë së pari me Abrahamin (Zanafilla 17: 7-12)**
 - a. Një besëlidhje e përhjetshme (v. 7)
 - b. Një zotërim i përhjetshëm (v. 8)
 - c. Shenja e besëlidhjes (v. 10-12)
- 4. Ata kujtuan sigurimin e Perëndisë.**
 - a. Në shkretëtirë—mana, ujë, shkurtat.
 - b. Tani frutat e Kananit (Jozueu 5:11,12).
- 5. Ata kujtuan zbulesën e Perëndisë.**
 - a. Në Sinai
 - b. Zbulesa e Perëndisë u rinovua si Kreu i Ushtrisë së Zotit që iu shfaq Jozueut (Jozueu 5:13-15).

PËRFUNDIM

Ne kemi nevojë për një falenderim si në Gilgal ku të kujtojmë shpengimin e Perëndisë, udhëheqjen e Tij, besëlidhjen, sigurimin dhe zbulesën e Tij në jetët tona. Kjo do të sjellë mirënjohje të madhe dhe adhurim në zemrat tona për Perëndinë. Kjo do të sigurojë gjithashtu më shumë nxitje për të jetuar për Të.

Nga: TERRY L. TERRELL



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR



Duke trainuar shërbyes që prej vitit 2003

Pastor, a keni nevojë që të zhvilloni bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në kishën tuaj? Lejoni që KTU të ndihmojë! KTU ekziston që...

- të përgatisë mbjellës kishash, pastorë, misionarë dhe shërbetarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe me një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën

...dhe është duke e përmbushur këtë qëllim. Pas dhjetë vitesh investimi në përgatitjen e shërbyesve, jemi duke parë frute. Pesëdhjetë të diplomuar janë duke ndikuar për Krishtin në shumë vende të Shqipërisë, Kosovës dhe të

Maqedonisë si dhe në kombe të tjera jashtë vendit.

Në KTU, studentët do të mësojnë rëndësinë e formimit transformues të karakterit, të jetës së krishterë në komunitet, doktrinës së shëndoshë, mësimi të mirë biblik, teologjik, misiologjik, si dhe përgatitjes së balancuar dhe serioze për shërbesë. KTU nuk është një shkollë dishepullizimi për besimtarë të rinj. Kjo është një shkollë biblike e një niveli universitar për ata që janë të thirrur për shërbesë.

Dërgimi i një studenti në KTU kërkon besim, përkushtim dhe sakrificë, por ju garantojmë që ia vlen të investosh. A dëshironi që shërbesa juaj të rritet? Atëherë mbillen farën në trainim. Në drejtues-misionar ka thënë, "Ai që trainon më shumë, korr më shumë shpirtëra të humbur." Bëni një hap besimi dhe do të shikoni çfarë Perëndia do të bëjë!



Për më shumë informacion, kontaktoni KTU@icc-al.org
Tel.: 048-302611 ♦ Cel.: 069-40-68956